

VENDIM PËR REGJISTRIM PERSONI JURIDIK

Sot, më datë 8 dhjetor 2008, unë Il Dopa gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studiova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. Ardian Garo në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë anonime "DDB ALBANIA" SHA për regjistrimin e kësaj shoqërie si person juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria anonime "DDB ALBANIA" SHA është person juridik i së drejtës shqiptare dhe ka për aksionerë a) "OLYMPIC DDB (Holding)" S.A. themeluar më 14 janar 1988, me numër regjistri 16436/01AT/B/88/012, me seli në Rrugën 12 Sorou, GR - 151 25, Amarousion, Athinë, Greqi; b) Ardian Garo lindur më 8 korrik 1970, në Vrisera, Gjirokastër, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335698; c) Pandeli Garo lindur më 6 Tetor 1964, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335699; d) Admir Banaj lindur më 23 gusht 1963, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës AZ nr. 447932.

Shoqëria anonime me emrin "DDB ALBANIA" SHA do të ketë formën e shoqërisë anonime.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Donika Kastrioti", Vila nr. 1/1, Tiranë, Shqipëri.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Marrja përsipër dhe kryerja e çdo biznesi reklamues, prodhimi i materialeve reklamuese dhe ofrimi i shërbimeve reklamuese në përgjithësi;
- Marrja përsipër, kryerja dhe ofrimi i shërbimeve të marrëdhënies për publikun, sponsorizimet, promocioneve të shitjeve dhe shërbime të komunikimit në përgjithësi.
- Marrja përsipër dhe kryerja e çdo veprimtarie tjetër në përmbushje të objektivave dhe veprimtarive të mësipërme.
- Kryerje studimesh dhe ofrim këshillash dhe shërbimesh në çështje organizimi, trainim personeli dhe funksionimi më efektiv të ndërmarrjeve dhe organizatave që janë në funksionim ose parashikohet të krijohen në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe çështje që kanë të bëjnë me plane investuese të këtyre shoqërive.
- Ofrim shërbimesh këshillimore financiare, investimesh, komunikimi dhe zhvillimi dhe në përgjithësi dhënia e shërbimeve këshilluese të të gjitha llojeve, natyrave dhe përmbajtjeve për persona fizikë dhe juridikë ose/dhe organeve të pushtetit lokal ose/dhe shtetit.
- Ofrim i shërbimeve të blerjeve dhe "central bying".
- Ofrim shërbimesh menaxhimi, tatimi, financiare, kompjuterizimi, organizimi dhe mbështetje dhe në përgjithësi shërbime personeli, udhëzim metodash të rritjes së shitjeve dhe administrimi financiar si dhe në përgjithësi ofrimi i shërbimeve të organizimit, drejtimit dhe administrimit të ndërmarrjeve.
- Ortakëri, dhe/ose drejtim ndërmarrjesh të tjera me anë të blerjes së aksioneve.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 000 000 (dy milion) lekë i ndarë në 2 000 aksione me vlere nominale 1 000 (një mijë) lekë secili.
Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë është z. Adrian Garo.

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Regjistrimin e Shoqërisë anonime "DDB ALBANIA" SHA si person juridik.
Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Donika Kastrioti", Vila nr. 1/1, Tiranë, Shqipëri.
Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:
 - Marrja përsipër dhe kryerja e çdo biznesi reklamues, prodhimi i materialeve reklamuese dhe ofrimi i shërbimeve reklamuese në përgjithësi;
 - Marrja përsipër, kryerja dhe ofrimi i shërbimeve të marrëdhënies për publikun, sponsorizimet, promocioneve të shitjeve dhe shërbime të komunikimit në përgjithësi.
 - Marrja përsipër dhe kryerja e çdo veprimtarie tjetër në përmbushje të objektivave dhe veprimtarive të mësipërme.
 - Kryerje studimesh dhe ofrim këshillash dhe shërbimesh në çështje organizimi, trainim personeli dhe funksionimi më efektiv të ndërmarrjeve dhe organizatave që janë në funksionim ose parashikohet të krijohen në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe çështje që kanë të bëjnë me plane investuese të këtyre shoqërive.
 - Ofrim shërbimesh këshillimore financiare, investimesh, komunikimi dhe zhvillimi dhe në përgjithësi dhënia e shërbimeve këshilluese të të gjitha llojeve, natyrave dhe përmbajtjeve për persona fizikë dhe juridikë ose/dhe organeve të pushtetit lokal ose/dhe shtetit.
 - Ofrim i shërbimeve të blerjeve dhe "central bying".
 - Ofrim shërbimesh menaxhimi, tatimi, financiare, kompjuterizimi, organizimi dhe mbështetje dhe në përgjithësi shërbime personeli, udhëzim metodash të rritjes së shitjeve dhe administrimi financiar si dhe në përgjithësi ofrimi i shërbimeve të organizimit, drejtimit dhe administrimit të ndërmarrjeve.
 - Ortakëri, dhe/ose drejtim ndërmarrjesh të tjera me anë të blerjes së aksioneve.
- Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 000 000 (dy milion) lekë i ndarë në 2 000 aksione me vlere nominale 1 000 (një mijë) lekë secili.
Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë është z. Adrian Garo.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE
Majlinda Lopo
Boff

VENDIM PËR DEPOZITIM AKTESH
PERSONI JURIDIK

Sot, më datë 28/1/ 2002, unë Majlinda Dogga, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studiova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. Ardian Garo në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë anonime "DDB ALBANIA" SHA për depozitimin e akteve të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria anonime "DDB ALBANIA" SHA është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar më datë 8 Janar 2001, me Vendimin Nr. 24894 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe ka për aksionerë a) Shoqërinë greke "OLYMPIC DDB (Holding)" S.A. b) Ardian Garo; c) Pandeli Garo; d) Admir Banaj.

Më datë 15 janar 2002, Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të shoqërisë DDB ALBANIA SHA ka vendosur ndryshimin e selisë së shoqërisë në adresën e re:

ZAYED BUSINESS CENTER, Rruga "Sulejman Delvina", Tirana e Re, Tiranë, Shqipëri

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë DDB ALBANIA SHA për ndryshimin e selisë së shoqërisë në adresën e re:

ZAYED BUSINESS CENTER, Rruga "Sulejman Delvina", Tirana e Re, Tiranë, Shqipëri

- Urdhërohet zyra e Regjistratit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skeden perkatese të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

MAJLINDA DOGGA



VENDIMI GJYQOTARIT TË VETËM

Sot, më datë 02.11. 2004, unë A. Ceca, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studiova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. Ardian Garo në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë "DDB ALBANIA" SHA për depozitim të akteve të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria "DDB ALBANIA" SHA është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar më datë 8 Janar 2001, me Vendimin Nr. 24894 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe ka për aksionerë a) Shoqërinë e së drejtës greke "OLYMPIC DDB (Holding)" S.A; b) Ardian Garo; c) Pandeli Garo dhe d) Admir Banaj.

Më datë 29 qershor 2004, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë DDB ALBANIA SHA, e cila vendosi përtëritjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë i cili përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Christos Papapolyzos (kryetar), shtetas grek, lindur më 10 dhjetor 1957, në Greqi, mbajtës i pasaportës Nr. K592016/3.3.1999.
2. Apostolos Fotopoulos (anëtar), shtetas grek, lindur më 09.12.1961, në Greqi, mbajtës i pasaportës me Nr. 0714695.
3. Pandeli Garo(anëtar), shtetas shqiptar, lindur më 6 tetor 1964, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH Nr. 335699.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës do të qëndrojnë në këtë detyrë për një periudhë tre vjeçare.

Më datë 29 qershor 2004, u zhvillua mbledhja e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, e cila vendosi emërimin në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë Z. Ardian Garo, shtetas shqiptar, lindur në 8 korrik 1970, ne Gjirokastrë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me numër QH 335698.

Drejtori i Përgjithshëm do të qëndrojë në këtë detyrë për një periudhë tre vjeçare.

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimn e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të shoqërisë DDB ALBANIA SHA për miratimin e përtëritjes së Këshillit Mbikqyrës dhe për një afat tre vjeçar.
- Depozitimn e Vendimit të Këshillit Mbikqyrës për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë Z. Ardian Garo dhe për një afat tre vjeçar.

Urdhërohet zyra e Regjistrit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

Ariane Ceco

AG

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
RREGJISTRI TREGTAR

URDHER RREGJISTRIMI

Kolona I	Numer i Rregjistrimit tregtar <u>24894</u>
Kolona II	A. Emri i Shoqerise <u>D B B Albamig Sh.A.</u> B. Selia <u>Comune Nr Durrës Traktinoti Vllë Nr 1</u> C. Objekti <u>kyçurje biznes, prokurim surat</u> <u>malimorshkollorsh, shkollore & imitari</u> <u>dhemere me parblim, - lolo veprimtarit fjetar etj</u> D. Kapitali <u>2.000.000 Lekë</u>
Kolona III	A. Ortaket <u>Olympic DDB Holding S.A. 60%</u> B. Administratoret: <u>Androni Jato 21%</u> <u>Armandi Jato 14%</u> <u>Adriana Bonaj 5%</u> <u>Adrian Jato - drejtor i përgjithshëm</u>
Kolona IV	Kohe zgjatja <u>15 vite</u>
Kolona V	Shenime mbi aktet e shoqerise A. Data e nenskrimit <u>18.12.2000</u> B. Data e rregjistrimit <u>8.1.2001</u> C. Statuti flete <u>14 flete</u> D. Akti i Themelimit flete <u>4 flete</u>

Shenime: Deklaratë e Bankës Alfa Tiranë Nr. 7493 datë 16.11.2000
Prokurim akt themelues, flete zyrtare, protokoll verbal, Deklaratë
malimorshkollorsh, etj.

GJYOTARE

M. Dajç
Dajç

AKT THEMELIMI I SHOQËRISE

“DDB ALBANIA” SHA



Aksionerët e mëposhtëm themelojnë Shoqërinë “DDB ALBANIA” SHA në përputhje me këtë Akt Themelimi, Statutin si dhe ligjin shqiptar “Për shoqëritë Tregtare”:

1. “OLYMPIC DDB (Holding)” S.A. themeluar më 14 janar 1988, me numër regjistri 16436/01AT/B/88/012 me seli në Rrugën 12 Sorou, GR – 151 25, Amarousion, Athinë, Greqi.
2. Ardian Garo lindur më 8 korrik 1970, në Vrisera, Gjirokastrë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335698.
3. Pandeli Garo lindur më 6 Tetor 1964, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335699.
4. Admir Banaj lindur më 23 gusht 1963, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës AZ nr. 447932.

Neni 1 Forma Ligjore

1. Shoqëria krijohet në formën e shoqërisë anonime në bazë të ligjit Shqiptar “Për Shoqëritë Tregtare”.

Neni 2 Emri

- 2.1 Emri i shoqërisë është “DDB ALBANIA” SHA.

Neni 3 Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë është në adresën Rruga “Donika KAstrioti”, Vila nr. 1/1, Tiranë, ALBANIA.

- 3.2 Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë zyra, filiale, agjenci ose të ofrojë shërbime në gjithë territorin e vendit me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

Neni 4 Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, duke filluar që nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

- 4.2 Shoqëria mund të përfundojë para këtij afati ose ta zgjasë këtë afat me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, në përputhje me ligjin shqiptar.

Neni 5

Objekti

5.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Marrja përsipër dhe kryerja e çdo biznesi reklamues, prodhimi i materialeve reklamuese dhe ofrimi i shërbimeve reklamuese në përgjithësi;
- Marrja përsipër, kryerja dhe ofrimi i shërbimeve të marrëdhënieve për publikun, sponsorizimet, promocioneve të shitjeve dhe shërbime të komunikimit në përgjithësi.
- Marrja përsipër dhe kryerja e çdo veprimtarie tjetër në përmbushje të objektivave dhe veprimtarive të mësipërme.
- Kryerje studimesh dhe ofrim këshillash dhe shërbimesh në çështje organizimi, trainim personeli dhe funksionimi më efektiv të ndërmarrjeve dhe organizatave që janë në funksionim ose parashikohet të krijohen në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe çështje që kanë të bëjnë me plane investuese të këtyre shoqërive.
- Ofrim shërbimesh këshillimore financiare, investimesh, komunikimi dhe zhvillimi dhe në përgjithësi dhënia e shërbimeve këshilluese të të gjitha llojeve, natyrave dhe përmbajtjeve për persona fizikë dhe juridikë ose/dhe organeve të pushtetit lokal ose/dhe shtetit.
- Ofrim i shërbimeve të blerjeve dhe "central bying".
- Ofrim shërbimesh menaxhimi, tatimi, financiare, kompjuterizimi, organizimi dhe mbështetje dhe në përgjithësi shërbime personeli, udhëzim metodash të rritjes së shitjeve dhe administrimi financiar si dhe në përgjithësi ofrimi i shërbimeve të organizimit, drejtimit dhe administrimit të ndërmarrjeve.
- Ortakëri, dhe/ose drejtim ndërmarrjesh të tjera me anë të blerjes së aksioneve.

5.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

5.3 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.

5.4 Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj.

Neni 6 Kontributet

6.1 Në çastin e krijimit të shoqërisë, kapitali themeltar i shlyer në lekë është 2 000 000 (dy milion).



6.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 2 000 aksione që kanë një vlerë nominale prej 1000 (një mijë) lekë secili. Aksionet janë të pandashme.

6.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht prej aksionerëve:

1. "OLYMIPC DDB (Holding)" S.A. zotëron 1 200 aksione (60 për qind të kapitalit aksioner) që i korrespondon shumës prej 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë.
2. Ardian Garo zotëron 420 aksione (21 për qind të kapitalit aksioner) që i korrespondon shumës prej 420 000 (katërqind e njëzetë mijë) lekë.
3. Pandeli Garo zotëron 280 aksione (14 për qind të kapitalit aksioner) që i korrespondon shumës prej 280 000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
4. Admir Banaj zotëron 100 aksione (5 për qind të kapitalit aksioner) që i korrespondon shumës prej 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 7 Organet e Shoqërisë

7.1 Organet e shoqërisë janë:

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, që është organi më i lartë i shoqërisë.

Këshilli Mbikqyrës që është organi që administroon shoqërinë. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga:

- | | |
|-------------------------|-----------|
| 1- Christos Papapolyzos | (Kryetar) |
| 2- Apostolos Fotopoulos | (antar) |
| 3- Pandeli Garo | (antar) |

Drejtoria e cila administron veprimtarinë e shoqërisë. Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë është z. Ardian Garo.

Neni 8 Viti Financiar

8.1 Viti financiar ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar që nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në gjykatë dhe mbaron në 31 Dhjetor 2000.

8.2 Këshilli Mbikqyrës mbikqyr llogaritë vjetore që të jenë në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin" dhe harton raportin mbi administrimin.

Neni 9 Dividendët

9.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe llogarotjen e shumës që do të ndahet,





Asambleja e Përgjithshme përcakton shumën që do tu jepet aksionerëve si dividend në bazë të neneve 215, 216 të ligjit të shoqërive.

Neni 10 Dispozita të Përgjithshme

10.1 Ky Akt Themelimi hartohet në 8 (tetë) kopje në gjuhën Shqipe dhe 8 (kopje) në gjuhën Greke dhe pasi u lexua nga aksionerët, u nënshkrua rregullisht prej tyre.

AKSIONERËT

1. Për shoqërinë "OLYMPIC DDB (Holding)" S.A. Përfaqësuesi me prokurë Ardian GARO
2. Per Z. Pandeli GARO Përfaqësuesi me prokurë Ardian GARO
3. Ardian GARO
4. Admir BANAJ

Ardian Garo
Pandeli Garo
Ardian Garo

Admir Banaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 130 / REP.
NR. 183 / KOL.

VËRTETIM

Sot më datë 18 dhjetor 2000 para meje Soukë Nona notere e Dhomës së Notereve Tiranë, u paraqitën personalisht:

- Ardian Garo lindur më 8 korrik 1970, në Vrisera, Gjirokastrë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335698.
- Admir Banaj lindur më 23 gusht 1963, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës AZ nr. 447932.

Të gjithë madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, të cilët në cilësinë e aksionerëve të shoqërisë "DDB ALBANIA" SHA Tiranë më paraqitën këtë Statut dhe pasi e nënshkruan atë rregullisht para meje, unë noterja e vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.



NOTERE

Soukë Nona



KAPITULLI I Themelimi - Menyra

Neni 1.

THEMELIMI – EMERTIMI

Krijohet shoqeria anonime me emrin “OLYMPIC DDB SHOQERI ANONIME DHENIE SHERBIMESH DHE INVESTIMESH” me emrin njohes “OLYMPIC DDB (Holding)”

Neni 2

SELIA

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Sorou 12 ne bashkine e Marusit dhe do te jete ne juridiksionin e saj, pervec rasteve kur parshikohet ndryshe nga ligji. Me vendim te Keshillit Administrativ mund te themelohen dege, agjensi, zyra ose thjesht perfaqesi te saj ne qytete te tjera te Greqise ose jashte.

Neni 3

OBJEKTI

1. Objekti i shoqerise eshte:
 - a. Kryerje studimesh dhe ofrim keshillash dhe sherbimesh ne ceshtje organizimi, trainim personeli dhe funksionimi me efektiv te ndermarjeve dhe organizatave qe jane ne funksionim ose parashikohet te krijohen ne Greqi dhe jashte, si dhe ceshtje qe kane te bejne me plane investuese te ketyre shoqerive.
 - b. Ofrim sherbimesh keshilltari financiar, investimesh, komunikimi dhe zhvillimi dhe ne pergjithesi dhenia e sherbimeve keshilluese te te gjitha llojeve karaktereve dhe permbajtjeve per persona fizike dhe juridike ose/dhe organeve te pushtetit lokal ose/dhe shtetit.
 - c. Kryerje sherbimesh blerjeje dhe dhenie sherbimesh “central buying”.
 - d. Ofrim sherbimesh menaxhimi, tatimi, financiare, kompjuterizimi, organizimi dhe mbeshtetje dhe ne pergjithesi sherbime personeli, udhezim metodash te rritjes se shitjeve dhe administrimi financiar si dhe ne pergjithesi ofrimi i sherbimeve te organizimit drejtimit dhe administrimit te ndermarjeve.
 - e. Ortakeri, dhe/ose drejtim ndermarrjesh te tjera me ane te blerjes se aksioneve dhe/ose pjeseve te tyre ne Greqi dhe jashte.
 - f. Marrje dhe kryerje te cdo lloj veprimi per aktivitetet e pershkruara me lart.
2. Per kete qellim shoqeria mund te themeloje dege agjensi ose zyra ne Greqi dhe te perfaqsoje shoqeri te huaja.
3. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe ne baze te ketij statuti eshte e mundur te zgjerohet objekti i shoqerise.

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise caktohet 15 (pesembedhjete) vjet duke filluar nga dita e themelimit te shoqerise ne baze te ligjit.

KAPITULLI 2 Kapitali Aksioner – Aksionet

Neni 5

KAPITALI AKSIONER

1. Kapitali fillestar u caktua pese milion drahmi (5,000.000) i ndare ne 500 aksione me vlere 10,000 drahmi secila. Kapitali i mesiperme u shtua me (70,000.000) shtatedhjete milion drahmi dhe u nxoren (7,000) shtatemije aksione me vlere (10,000) dhjetemije drahmi secila me vendim te Asamblese se Pergjitheshme te dates 27/9/93. Pas shtimit te kapitalit ne fjale kapitali i pergjithshem aksioner i shoqerise behet (75,000.000) shtatedhjete e pese milion drahmi dhe ndahet ne (7.500) shtate mije e peseqint aksione me vlere (10.000) dhjetemije drahmi secila.
2. Ne baze te ketij statuti, gjate pese vjecarit te pare nga koha e themelimit te shoqerise, Keshilli Administrativ ka te drejte te marre vendime me me shume se 2/3 e votave te anetareve, te zmadhoje kapitalin aksioner duke emetuar aksione te reja me vlere deri ne vleren e kapitalit te shoqerise. E drejta ne fjale e Keshillit Administrativ mund te riperterihet nga Asambleja e Pergjithshme per afate kohore qe nuk i kalojne 5 (pese) vjet per cdo riperteritje.
3. Gjithashtu, ne baze te ketij statuti Asambleja e Pergjithshme ka te drejten, te marre vendime ne baze te dispozitave te nenit 14 te ketij dokumenti, te zmadhoje kapitalin aksioner nepermjet emetimit te aksioneve te reja deri ne katerfishin e kapitalit fillestar te vendosur ne kompani ose me dyfishin e kapitalit ne kohen qe behet ky zmadhim.
4. Me perjashtim te dispozitave te mesiperme, kerkohet gjithmone qe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te merren ne baze te dispozitave te nenit 15 te ketij statuti mbi pjesemarjen dhe shumicen ne rast se fondet e arkes te shoqerise se formuar nga ky statut kalojne nje te dhjeten (1/10) e kapitalit aksioner fillestar.
5. Zmadhimi i kapitalit i permenduar ne paragrafet 2 dhe 3 te ketij neni nuk perben pershtatje te tij.

Neni 6

1. Aksionet e shoqerise jane nominale, dhe shnderohen ne anonime me vendim te Asamblese te Pergjithshme te marre ne baze te nenit 15 te statutit dhe te pershtatjes se ketij neni. Certifikatat e aksioneve mund te perfaqesojne nje ose me teper aksione. Ceshtjet rreth emetimit te aksioneve rregullohen nga Keshilli Administrativ. Titujt e aksioneve priten nga nje liber me 2 kopje, do te jene me numera dhe do te kene te shkruar siper daten e emetimit, numrin e aksioneve, firmat e Kryetarit te Keshillit Administrativ, firmen e nje prej Drejtoresve te Keshillit Administrativ te caktuar nga keshilli dhe vulen e shoqerise dhe duhet te jene te shoqeruara nga kupona me numra. Deri ne emetimin e certifikatave perfundimtare, emetohen, me dijeni te Keshillit Administrativ, tituj te perkohshem qe kane te shkruar siper sa me lart pervec kuponave.

2. Te drejtat dhe detyrat e cdo aksioni ndjekin pronarin e tyre te ligjshem. Pronari i ligjshem konsiderohet se pranon kete statut dhe vendimet e ligjshme te Asamblese se Pergjithshme dhe Keshillit Administrativ.
3. Cdo aksioner pavaresisht se ku jeton, persa i perket lidhjeve me shoqerine, konsiderohet se ka si vend banimi seline ku eshte regjistruar shoqeria dhe u nenshtrohet ligjeve greke.

KAPITULLI 3

Aksioneret

Neni 7

TE DREJTAT E AKSIONEREVE

1. Aksioneret ushtrojne te drejten e tyre ne lidhje me administrimin e shoqerise vetem nepermjet Asamblese se Pergjithshme.
2. Cdo aksion jep te drejten e 1 vote ne Asamblene e Pergjithshme.

3. Ne cdo lloj zmadhimi te kapitalit te shoqerise qe nuk behet me para apo me emetim te letrave me vlere me te drejte transformimi ne aksione, aksioneret ekzistues ne momentin e emetimit te ketyre aksioneve te reja kane te drejten e parablerjes per te marre pjese ne ndarjen e tyre sipas perqindjes se aksioneve qe zoterojne ne kapitalin fillestar. Pas kalimit te afatit brenda te cilit mund te perdoret kjo e drejte qe rregullohet nga instrumentat e shoqerise qe percaktojne rritjen e kapitalit te shoqerise, dhe qe s'duhet te jete me pak se nje muaj, cdo aksion i ri qe nuk eshte terhequr nga aksioneret e vjeter shperndahet lirisht nga Keshilli Administrativ i shoqerise.

4. Ftesa per te ushtruar te drejten e parablerjes ne te cilen perfshihet dhe afati brenda te cilit duhet te ushtrohet kjo e drejte, publikohet ne fashikullin e SH.A. dhe SH.P.K. te gazetes zyrtare te Qeverise. Si perjashtim, nese te gjitha aksionet jane nominative, ftesa per ushtrimin e te drejtes se parablerjes mund te behet me letra rekomande qe u dergohen aksionereve.

Me kufizimet e percaktuara ne paragrafet 6 dhe 7 te nenit 13 te Ligjit 2190/20 sic eshte ne fuqi, kufizohet ose te hiqet e drejta e mesiperme e parablerjes me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Ne rast te transferimit te aksioneve, e drejta e parablerjes u takon aksionereve te tjere te shoqerise. Personi qe do te shese aksionet duhet te lajmeroje shoqerine me shkrim. Ne qofte se shoqeria ne nje afat prej 20 ditesh nga marrja e njoftimit i afron nje bleres per te gjitha ose nje pjese te aksioneve, personi qe do te shese aksionet eshte i detyruar te preferoje bleresin ne fjale. Para se te beje tregimin e bleresit shoqeria duhet te lajmeroje te gjitha aksioneret e saj pa perjashtim per aksionet e nxjera ne shitje dhe ti ftojte te shprehin deshiren per ti blere keto aksione. Ne rast se shoqeria brenda afatit 20 ditor nuk i ofron bleres personit qe do te shese aksionet, ky i fundit mund t'ia kaloje ato kujdo. Ne menyre te vecante themeluesit e shoqerise mund te transferojne lirshem nje pjese ose te tera aksionet e tyre shoqerise meme ose shoqerive bija ose te kontrolluara nga ajo, qe egzistojne

gjate hartimit te ketij statuti, mjafton te lajmerojne shoqerine per kete transferim 10 dite perpara.

Neni 8

TE DREJTAT E PAKICES

1. Me kerkesen e aksionereve qe perfaqesojne nje te njezetën (1/20) e kapitalit fillestar, Keshilli Administrativ eshte i detyruar te mbledhe jashte rradhe Asamblene e Pergjithshme te aksionereve duke caktuar nje date mbedhjeje qe nuk duhet te jete me vone se nje muaj nga dita qe kerkesa i eshte dorezuar Kryetarit te Keshillit Administrativ. Caktohet gjithashtu saktesisht rendi i dites.
2. Me kerkesen e aksionereve qe perfaqesojne nje te njezetën (1/20) e kapitalit Kryetari i Asamblese eshte i detyruar te shtyje vetem nje here marrjen e vendimeve nga Asambleja e Pergjithshme e zakonshme ose e jashtezakonshme duke caktuar nje dite mbedhjeje per marrjen e vendimeve sipas kerkeses se aksionereve te lartpermendur jo me vone se 30 dite nga data e shtyrjes.
3. Me kerkesen e aksionereve qe perfaqesojne nje te njezetën (1/20) e kapitalit aksioner, te depozituar ne shoqeri pese (5) dite te plota para Asamblese se Pergjithshme Keshilli Administrativ eshte i detyruar:
 - a. Te beje publike para Asamblese se Pergjithshme te aksionereve shumate qe gjate 2 vjecarit te fundit iu dhane, per cfaredolloj aresyeje, nga shoqeria anetareve te Keshillit Administrativ, Drejtoresve dhe nepunesve te tjere, si dhe cdo lloj konsiderate tjeter per keta persona te siperpermendur dhe kontrata qe shoqeria mund te kete me ta per cdo lloj aresyeje.
 - b. Tu paraqese kerkuesve informacione konkrete per ceshtjet e shoqerise ne masen qe ato jane te dobishme per vleresimin e vertete te temave te rendit te dites. Keshilli Administrativ mund te refuzoje dhenien e informacioneve te tilla per aresye te bindsheme, dhe aresyeja duhet te shkruhet ne protokoll.
4. Me kerkesen e aksionereve qe perfaqesojne nje te tretën (1/3) e kapitalit, te depozituar ne shoqeri brenda afateve te percaktuara ne paragrafin e mesiperm, dhe me kusht qe ata nuk perfaqesohen ne Keshillin Administrativ, ky i fundit ashte i detyruar tu jape atyre, gjate Asamblese se Pergjithshme, informacione per ecurine e shoqerise dhe gjendjes se pasurise se saj, ose neqoftese ata preferojne, t'jua jape perfaqesuesve te tyre perpara mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme. Keshilli Administrativ mund te refuzoje dhenien e informacioneve te tilla per aresye te bindshme, dhe arsyertimi shkruhet ne protokoll.
5. Ne rastet e pjeses se dyte te paragrafit 3 dhe paragrafin 4 te nenit te mesiperm, ankesat dhe dyshimet per bazueshmerine e arsytimit te refuzimit zgjidhen nga gjykata kompetente e shkalles se pare te qendres ky shoqeria eshte regjistruar, gjate procedures se ankimit ne te.
6. Me kerkesen e aksionereve qe perfaqesojne nje te njezetën (1/20) e kapitalit, marrja e vendimeve per ceshtjet e rendit te dites te Asamblese se Pergjithshme merret me votim te hapur sipas listes emerore.

7. Ne rastet e paragrafeve 1 dhe 4 te ketij neni, aksioneret qe bejne kerkesen jane te detyruar, ne baze te nenit 12 te ketij statuti, te mbajne te depozituar ne emrin e tyre aksionet e tyre, nga periudha kur bejne kerkesen deri ne ditën mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme ose ne rastin e paragrafit 5 deri ne ditën e dhenies se vendimit nga gjykata kompetente.
8. Aksionere qe perfaqesojne te pakten nje te njezetën 1/20 e kapitalit kane te drejte te kerkojne te kontrollohet shoqeria nga gjykata kompetente e shkalles se pare e prefektures ku ka seline shoqeria ne baze te procedurave ligjore. Urdherohet kryerja e kontrollit neqoftese thuhet se dyshohet se gjate kryerjes se veprimeve te akuzuara, jane shkelur ligjet, ky statut ose vendimet e Asamblese se Pergjithshme. Veprimet e akuzuara duhet te jene bere brenda 2 vjeteve nga koha e aprovimit te raportit vjetor financiar per periudhen ne te cilen jane kryer keto veprime te akuzuara.
9. Aksioneret e shoqerise, qe perfaqesojne te pakten nje te terten (1/3) e kapitalit aksioner kane te drejte te kerkojne kontroll te shoqerise nga gjykata kompetente e percaktuar ne paragrafin e meparshem, nese ne te tere punen e shoqerise, mund te besohet se menaxhimi i puneve te saj nuk behet sipas principeve te shendosha dhe eficente te menaxhimit. Kjo dispozite nuk zbatohet kur pala kerkuese perfaqesohet ne Keshillin Administrativ te shoqerise.
10. Kerkuesit ne baze te paragrafeve 8 dhe 9 te ketij neni, duhet qe te depozitojne aksionet e tyre, ne baze te te cilave ata kane te drejte te bejne kete kerkese, ne Arken e Depozitave dhe te Huave ne Banken e Greqise ose ne cdo banke te njohur greke, dhe per cdo rast, per nje periudhe me te madhe se 30 dite nga depozitimi i kerkeses

KAPITULLI VI Asambleja e Pergjithshme

Neni 9

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE PERGJITHESHME

1. Asambleja e Pergjithshme e aksionereve te shoqerise eshte organi me i larte i saj dhe ka te drejte te vendose per cdo problem qe ka te beje me shoqerine. Vendimet e ligjshme te saj jane detyruese edhe mbi ata qe mungojne ose nuk jane dakort.
2. Asambleja e Pergjithshme eshte i vetmi trup kompetent qe mund te marre vendime persa i perket
 - a. Zgjatjes e kohes se vaprimitarise se shoqerise, bashkimin me kompani te tjera ose shperberjen e saj.
 - b. Pershatje te statudit
 - c. Shtesat (pervec asaj qe permendet ne paragrafin 2 te nenit 8 te ketij statuti) ose pakesimet e kapitalit.
 - d. Emetim huaje me ane te bonove, si dhe bono sipas neneve 3a, 3b dhe 3c te Ligjit 2190/1920.
 - e. Zgjedhjen e anetareve te Keshillit Administrativ me perjashtim te rastit te permendur ne nenin 22 te ketij statuti.
 - f. Shkarkimin e anetareve te Keshillit Administrativ
 - g. Zgjedhjen e kontrolloreve

- h. Emerimin e likuiduesve
- i. Shpendarjen e fitimeve neto vjetore
- j. Aprovimin e raporteve financiare vjetore
- k. Cdo shtim te pergjegjesive te partnereve.

Neni 10

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

1. Asambleja e Pergjithshme e aksionereve thirret gjithmone nen Keshillin Administrativ, behet rregullisht ne seline e shoqerise, cdo vit, dhe brenda 6 mujorit te pare pas mbylljes se cdo viti ekonomik. Keshilli Administrativ mund te mbledhe jashte radhe Asamblene e Pergjithshme te aksionereve sa here e gjykon te nevojshme
 - a. Asambleja e pergjithshme, me perjashtim te mbledhjeve te perseritura dhe te njgjashme me to, duhet te therritet 20 dite perpara dites se caktuar per tu mbajtur, duke perfshire dhe ditet e vecanta. Dita e publikimit te fteses te Asamblese se Pergjithshme dhe dita e mbledhjes nuk llogariten.

Neni 11

FTESAT – RENDI I DITES I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Ne ftesat e aksionereve per Asamblene e Pergjithshme, shkruhet dita, ora dhe vendi ku do te mblidhet asambleja dhe ceshtjet e rendit te dites me qartesi. Ftesat per mbledhje te regullt ose te jashtezakonshme botohen te pakten 10 dite perpara ne fashikullin e SHA dhe SHPK te gazetes zyrtare sipas nenit 3 te Dekretit Presidential date 16.1.1930 dhe te pakten 20 dite perpara ne nje nga gazetatat politike te Athines qe zgjidhet nga gazetatat qe percakton neni 3 i ligjit 3757/1957, me tirazh me te larte ne te gjithe vendin sipas gjykimit te Keshillit Administrativ, dhe nje gazete ekonomike te perditshme qe eshte botuar pa nderprerje, te pakten per 3 vitet e fundit dhe qe shesin te pakten 5,000 gazeta ne dite dhe qe jane caktuar nga Ministria e Tregtise, ngjiten ne mur ne vend te dukshem ne ndertesen e shoqerise, per mbledhjet e perseritura afatet e mesiperme pergjysmohen.
2. Keshilli Administrativ i shoqerise eshte i detyruar qe 10 dite perpara mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme ti jape cdo aksioneri raportet vjetore financiare dhe kopje te raportit te Keshillit Administrativ dhe raportit te kontrolloreve.

Neni 12

DEPOZITIMI I AKSIONEVE – PERFAQESIMET

1. Aksioneret qe deshirojne te marin pjese ne Asamblene e Pergjithshme duhet te dorezojne titujt e aksioneve te tyre ne arken e shoqerise ose ne Arken e depozitimeve dhe huave ose ne kedo banke Greke te pakten pese (5) dite te plota perpara dites se percaktuar per mbledhjen e asamblese.
2. Aksioneret qe kane te drejte pjesemarje te marin pjese ne Asamblene e Pergjithshme mund te perfaqesohen ne te me persona te autorizuar ligjshem nga ta.
3. Vertetimet e depozitimin e aksioneve ose dokumentat e ligjerimit te perfaqesuesve te aksionereve duhet te depozitohen prane shoqerise te pakten pese (5) dite te plota para dites se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

4. Aksioneret qe nuk bien dakort me paragrafet 1 dhe 3 te ketij neni mund te marin pjese ne Asamblene e Pergjithshme vetem pas lejes se saj.

Neni 13

TABELA E ATYRE QE KANE TE DREJTEN E VOTES

48 ore para cdo Asambleje te Pergjithshme publikohet ne mur ne nje vend te dukshem te qendres se shoqerise, tabela e atyre qe kane te drejte vote gjate Asamblese se Pergjithshme te aksionereve, ose perfaqesueseve te tyre, te numrit te aksionereve dhe votave te tyre dhe adresat e aksionereve ose perfaqesuesve te tyre.

Neni 14

MOSPJESEMARJA E VAZHDOESHME DHE SHUMICA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Asambleja e Pergjithshme quhet e mbledhur dhe do te vazhdoje te kryeje funksionet ne menyre te ligjshme sipas ceshtjeve te rendit te dites kur marin pjese ne te ose perfaqesohen gjate saj aksionere qe perfaqsojne te pakten 1/5 e kapitalit te vene aksioner.
2. Neqoftese asambleja nuk mblidhet per shkak te mungeses ne pjesemarrje ne sesionin e pare, behet mbledhje perseritese brenda 20 diteve nga data e mbledhjes se shtyre, e mbledhur te pakten 10 dite me perpara, quhet e mbledhur dhe vazhdon te kryeje funksionin e saj rregullisht bazuar mbi ceshtjet e rendit fillestar te dites pavaresisht nga sasia e kapitalit aksioner te paguar qe ka perfaqesim aty.
3. Vendimet e Asamblese se Pergjithshme merren me shumice absolute te votave te perfaqesuara pjesemarese ne mbledhje.

Neni 15

PJESMARRJA SPECIALE DHE MAXHORANCA NE ASAMBLENE E PERGJITHSHME

1. Pervercse ne rastin ne rastin kur merren vendime mbi ceshtjet e shprehura ne Nenin 9, paragrafin 2, dhe vendimeve per te ndryshuar kombesine e shoqerise, aktivitetin, shperndarjen e fitimit, rastit te permendur ne nenin 26 te te njejtut statut, me perjashtim te paragrafit 2, nen-paragrafi "f" te nenit 9 te ketij statuti, per te cilen duhet nje e pesta (1/5) e aksioneve te kapitalit te paguar, Asambleja e Pergjithshme do te quhet e mbledhur dhe do te ndjeke proceduren e rendit te dites kur dy te tretat (2/3) e aksioneve te kapitalit te paguar dhe perfaqesuesit e tyre jane te pranishem aty.
2. Neqoftese nje pjesemarrje e tille nuk eshte arritur ne sesionin e pare, nje mbledhje e pare e nje serie te tillash do te mbahet brenda njezete (20) diteve nga dita e mbledhjes se shtyre, ne rastin kur kjo mbledhje behet te pakten dhjete (10) dite me pare; Asambleja do te quhet e mbledhur dhe do te ndjeke proceduren e rendit te dites te mbledhjes se pare neqoftese nje e dyta (1/2) e aksioneve te kapitalit te paguar eshte e perfaqesuar aty.
3. Neqoftese nje pjesmarrje e tille nuk arrihet dhe kete here, nje mbledhje e dyte e rradhes mbahet brenda njezete (20) diteve nga dita e anullimit te mbledhjes se shtyre,

- ne rastin kur kjo mbledhje behet te pakten dhjete (10) dite me perpara; Asambleja do te quhet e mbledhur dhe do te ndjeke proceduren e rendit te dites te mbledhjes se pare neqoftese nje e treta (1/3) e aksioneve te kapitalit te paguar eshte e perfaqesuar aty.
4. Te gjitha vendimet e pershkruara ne pragrafin 1 te ketij neni do te merren nga nje maxhorance prej dy te tretatsh (2/3) te votave te perfaqesuara ne kete mbledhje.

Neni 16

KRYETARI - SEKRETARI I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Asambleja e Pergjithshme do te kryesohet perkohesisht nga Kryetari i Keshillit Administrativ ose, neqoftese ai eshte i pamundur per te kryer kete detyre, nga zevendesi i tij. Detyrat e Sekretarit do te kryhen perkohesisht nga nga personi i emeruar nga Kryetari.
2. Pasi lista e aksionereve qe kane te drejten e votes perfundohet, mbledhja do te vazhdoje me zgjedhjen e Kryetarit te perhershem dhe te nje sekretari qe do te veproje si numerues votash.

Neni 17

CESHTJET PER DISKUTIM – PROCESVERBALET E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Diskutimet e bera dhe vendimet e marra ne Asamblene e Pergjithshme do te kufizohen ne pikat e rendit te dites.
2. Per diskutimet e mbajtura dhe vendimet e marra mbahet procesverbal. Procesverbalet do te nenshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari.
3. Kopje dhe pjese te procesverableve vertetohen nga Kryetari i Keshillit Administrativ ose zevendesuesi i tij.

Neni 18

CLIRIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT ADMINISTRUES DHE KONTROLLOREVE

1. Pas te jene aprovuar raportet financiare, Asambleja e Pergjithshme do te vendosi, me votim sipas listes, perjashtimin e anetareve te Keshillit Administrativ dhe kontrolloreve nga detyrimi per shperblimin e demit.
Ky clirim do te jete i pavlefshem ne rastet e permendura ne nenin 22a te Ligjit 2190/1920.
2. Anetaret e Keshillit Administrativ mund te marrin pjese ne votimin lidhur me perjashtimin nga detyrimi te Keshillit Administrativ vetem me numrin e votave qe korrespondon me numrin e aksioneve qe ata zoterojne.
E njejta gje do te aplikohet ne rastin e te punesuarve ne shoqeri.

KAPITULLI V Keshilli Administrativ

Neni 19

PERBERJA DHE KOHEZGJATJA E KESHILLIT ADMINISTRATIV

1. Shoqeria do te drejtohet nga nje Keshill Administrativ te perbere nga 5-11 anetare.
2. Anetaret e Keshillit Administrativ do te zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme e aksionereve te shoqerise per nje perjude prej kater (4) vjetesh qe mund te zgjatet deri sa te mbahet mbledhja e pare e zakonshme e Asamblese se Pergjithshme pas mbarimit te perjudhes per te cilen eshte zgjedhur Keshilli, kohezgjatja totale e se ciles nuk mund te kaloje pese (5) vjet.
3. Anetaret e Keshillit Administrativ mund te rizgjidhen.

Neni 20

FUQITE DHE DETYRIMET E KESHILLIT ADMINISTRATIV

1. Keshillit Administrativ do ti besohet menaxhimi (administrimi dhe kontrolli) i aseteve te shoqerise dhe detyra e perfaqesimit te shoqerise. Keshilli do te vendose, ne pergjithesi per te gjitha ceshtjet qe lidhen me shoqerine brenda kufijve te percaktuar nga fusha e veprimit te shoqerise, me perjashtim te atyre te cilat, sipas ligjit ose ketij statuti, jane kompetence ekskluzive e Asamblese se Pergjithshme. Ne cdo kohe, fuqite e Keshillit Administrativ do te jene subjekt i nenit 10 dhe 23a te Ligjit 2190/1920 sic eshte permiresuar dhe tanime ne fuqi.
2. Keshilli Administrativ mund t'ja delegoje te tera fuqite e tij dhe detyrimet (me perjashtim te atyre qe kerkojne veprim kolektiv), si dhe perfaqesimin e shoqerise, nje apo disa individeve, pavaresisht nese jane anetare te Keshillit ose jo, duke shpjeguar dhe kushtet dhe masen e ketij delegimi.

Neni 21

FORMIMI I KESHILLIT ADMINISTRATIV

1. Mbas zgjedhjes, Keshilli Administrativ do te mblidhet dhe do te krijoje nje ekip duke zgjedhur Kryetarin dhe Zevendes Kryetarin.
2. Keshilli mund te zgjedhi nje ose disa nga anetaret e tij ne postin e Drejtorit Manaxhues, duke percaktuar njekohesisht te drejtat dhe detyrimet e tij.
3. Kryetari i Keshillit Administrativ do te kryesoje mbledhjet e Keshillit. Ne qofte se Kryetari mungon apo eshte i pamundur te kryeje detyren e tij ai do te zevendesohet, me fuqi te plota nga Zevendes Kryetari dhe neqoftese dhe ky i fundit mungon apo i pamundur te kryeje detyren e tij ai do te zevendesohet, me ane te nje vendimi te Keshillit Administrativ, nga Drejtori Menaxhues ose nje tjetere anetar i Keshillit Administrativ.

Neni 22

ZEVENDESIMI I NJE ANETARI TE KESHILLIT ADMINISTRATIV

Neqoftese per ndonje arsye, vendi i nje drejtori ngelet bosh, drejtoret e ngelur, te cilet duhet te jene te pakten 4 ne numer, do te zgjedhin nje zevendesues per kohen e ngelur nga perjudha e mbetur per te cilen drejtori i me siper duhej te sherbente.

Per marrjen e ketij vendimi, te gjithë drejtoret duhet te jene te pranishem dhe vendimi duhet te merret unanimisht. Ky vendim do t'i jepet per aprovim mbledhjes se rradhes se Asamblese se Pergjithshme. Neqoftese nuk mund te merret nje vendim per shkak te mos arritjes se shumices, Keshilli Administrativ detyrohet te kerkoje nje mbledhje te jashtezakonshme te Asamblese se Pergjithshme per te vendosur mbi kete ceshtje. Veprimet e nje drejtori te zgjedhur ne kete menyre quhen te vlefshme, edhe neqoftese zgjedhja e tij nuk eshte aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme.

Neni 23

MBLEDHJET E KESHILLIT TE DREJTOREVE

Keshilli Administrativ do te mblidhet ne qytetin ne te cilin shoqeria eshte regjistruar dhe do te therritet nga Kryetari i Keshillit te pakten nje here ne muaj.

Neni 24

PERFAQESIMI I ANETAREVE – PJESMARRJET – MAXHORANCA

1. Nje drejtor qe mungon mund te perfaqesohet nga nje drejtor tjetër. Cdo drejtor ka te drejte te perfaqesoje jo me shume se nje drejtor qe mungon.
2. Keshilli Administrativ do te konsiderohet i mbledhur dhe mbledhja do te vazhdoje neqoftese te pakten gjysma plus nje e anetareve te saj jane te pranishem ose te perfaqesuar. Megjithate ne asnje rast numeri i drejtoresve te pranishem nuk duhet te jete me pak se tre (3).
3. Vendimet e Keshillit Administrues do te arrihen me shumicen absolute te drejtoresve te pranishem ose te perfaqesuar, pa paragjykime ndaj nenit 5, paragrafi 2, dhe nenit 22 te ketij statuti.
4. Specifikisht, vendimet e Keshillit te Drejtoresve ne rastet e meposhtme do te merren atehere kur te gjithë anetaret e Keshillit te jene te pranishem dhe te veprojne unanimisht.
 - i. Ngritja e cdo dege te shoqerise
 - ii. Blerja apo shitja e nje prone te patundshme apo regjistrimi si kolateral i nje prone te patundshme te shoqerise.
 - iii. Pranimi i garancive per borxhe apo krijim, pranim apo garanci i cdo lloj borxhi pervec borxheve te llogarise dhe detyrime te tjera qe krijohen nga aktivitetet e zakonshme te shoqerise.
 - iv. Ngarkimi (kolateral, depozita sigurie, etj), heqja dore (shitje, etj), apo blerja ne cdo lloj menyre te prones kur vlera totale e secilit element te prones kalon shumen nje milion dhrahmi (1,000.000 Drh).

- v. Dhenia e borxheve apo parapagimet pervec se ne rastet kur u behen te punesuarve te shoqerise per paradhnie qe korrespondojne me shpenzimet per aktivitetet e zakonshme te shoqerise.
- vi. Ngritja e rrogave, pagesa te pazakonta ose shperblime qe kalojne shumen e njezete million (20,000.000) drahami, lidhja e kontratave te punes me drejtues te shoqerise me shperblime vjetore qe kalojne shumen njezet milion (20,000.000) drahami.
- vii. Lidhja e kontratave direkt ose indirekt me agjensi te tjera reklamash qe menjanon themeluesit dhe kompanite pjesemarrese, por jo kur ky kontraktim kryhet per llogari te nje klienti te shoqerise.

Neni 25

DETAJE TE MBLEDHJES SE KESHILLIT ADMINISTRATIV

1. Detajet e diskutimeve te mbajtura dhe vendimeve te marra nga Keshilli Administrativ do te mbahen shenim.
2. Kopje ose pjese te detajeve te mbledhjeve te Keshillit te Drejtoreve do te vertetohen nga Kryetari ose zevendesi i tij.

Neni 26

SHPERBLIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT ADMINISTRATIV

1. Anetaret e Keshillit Administrativ mund te marrin shperblime, shuma e te cilave percaktohet me vendim te vecante ne mbledhjet e zakonshme te Asamblese se Pergjithsme.
2. Cdo shperblim apo kompensim tjetër i Anetareve te Keshillit Administrativ do t'ju paguhet vetem nga shoqeria ne qofte se shuma per t'ju paguar secilit drejtor eshte aprovuar nga nje vendim i posacem i Asamblese se Pergjithshme.
3. Ne te dyja rastet e mesiperme, vendimet e Asamblese se Pergjithshme do te merren ne mbledhje dhe ne shumice sic e percakton neni 15 i ketij statuti.

Neni 27

NDALIMI I KONKURRENCES

1. Anetaret e Keshillit Administrativ dhe manaxheret e shoqerise nuk mund te perfshihen, profesionalisht, pa pelqimin e Asamblese se Pergjithshme, per llogari te tyre ose te paleve te treta, ne aktivite, te lidhura me objektivat e shoqerise ose te behen partnere ne partneritete te pergjithshme te pakufizuara objektivat e te cileve jane te njejta me ate te shoqerise.
2. Ne rast te thyerjes se ketij rregulli, shoqeria do te rezervoje te drejten per te kerkuar demshperblim sipas nenit 23, paragrafit 2, dhe 3, te Ligjit 2190/1920.
3. Drejtoret e pare te emeruar ne baze te nenit 36 te ketij dokumenti kane te drejten qe deri ne mbledhjen e pare te rregullt ose joformale te Asamblese se Pergjithshme te aksionereve te shoqerise te vazhdojne per llogari te tyre ose per llogari te paleve te treta, aktivite qe kane te njejtat objektiva sic dhe shoqeria ose te marrin pjese si partnere te pergjithshem te kompanive qe kane te njejtat qellime.

KAPITULLI VI

Auditimi

Neni 28

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

1. Cdo vit, Asambleja e Pergjithshme ne mbledhje te zakonshme do te zgjedhe dy eksperte kontabel te autorizuar dhe dy zevendesues si dhe do te percaktoje rrogat e tyre.
2. Brenda pese (5) diteve te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme ne te cilen ekspertet kontabel te autorizuar jane emeruar, shoqeria duhet ti beje atyre te ditur emerimin. Neqoftese ata nuk e kundershtojne kete emerim brenda pese diteve nga lajmerimi do te thote se ata e kane pranuar ate dhe se do te kene te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe percaktohen ne nenin 37 dhe nenin 43a, paragrafi 3, te ligjit 2190/1920 te permiresuar dhe tashme ne fuqi.
3. Asambleja e Pergjithshme mund te zgjedhi vetem nje ekspert kontabel te autorizuar dhe nje zevendes ekspert kontabel te autorizuar me kusht qe ata te jene te licensuar. Megjithate, neqoftese kufizimi i percaktuar ne paragrafin 6 te nenit 42a se bashku me nenin 70b te Ligjit 2190/1920 sic dhe eshte permiresuar me Dekretin Presidential 409/86 dhe tashme ne fuqi, nuk jane marre parasysh, zgjedhja e eksperteve kontabel te licensuar do te jete e detyrueshme.

KAPITULLI VIII

Raporti Vjetor Financiar – Fitimet dhe Humbjet

Neni 29

VITI FINANCIAR

Viti financiar do te zgjase per 12 Muaj, duke filluar ne 1 Janar dhe mbaruar ne 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtim ben viti i pare i cili fillon me themelimin ne baze te ligjit te shoqerise dhe mbaron ne 31 Dhjetor 1989.

Neni 30

RAPORTI VJETOR FINANCIAR

1. Ne fund te cdo viti financiar, Keshilli Administrativ do te pergatise Raportin Vjetor Financiar qe permendet ne nenin 42a, paragrafi 1, sic e parashikojne neni 42a, 42b, 42c, 42d,e 43, 43a, 43b, 70a, 70b, me permiresimet dhe tanime ne fuqi, te Ligjit 2190/20 te cilat (raportet) do ti dorezohen per aprovim Asamblese se Pergjithshme dhe do te shoqerohen nga:
 - a. nje raport shpjegues nga Keshilli Administrativ qe permban te gjitha detajet te permendura ne nenin 43a, paragrafi 3, nen-paragrafi a dhe b i Ligjit 2190/1920 sic eshte permiresuar dhe nga Dekreti Presidential 409/86, dhe
 - b. nga raporti i eksperteve kontabel te autorizuar

2. Bilanci i shoqerise, llogarite "fitime dhe humbje" dhe "tabela ilustruese e shperndarjes se fitimit" se bashku me nje certificate auditimi neqoftese nje kontroll nga nje ekspert kontabel i autorizuar eshte ofruar, do te publikohet te pakten njezet (20) dite perpara mbledhje se Asamblese se Pergjithshme, sic e parashikon neni 43b, paragrafi 5, i Ligjit 2190/1920 qe eshte ne fuqi se bashku me permiresimet e Dekretit Presidential 409/86.
3. Ne menyre qe Raporti financiar te aprovohet ne menyren e duhur nga Asambleja e Pergjithshme, ato duhet qe me perpara te kontrollohen nga kontrolloret e shoqerise dhe te certifikohen ne menyre te vecante nga:
 - a. Drejtori Menaxhues dhe ne mungese te tij nga nje anetar i Keshillit te Administrativ qe zgjidhet nga ai.
 - b. Menaxheri i Pergjithshem i shoqerise
 - c. Kryefinancieri.

Neni 31

SHPERNDARJA E FITIMIT

Pa paragjykime, sic parashikohet nga neni 37 i Dekretit Presidential 409/86, dhe neni 44a i Ligjit, fitimi neto i shoqerise do te shperndahet si me poshte:

- a. Pese per qind (5%) e fitimit do te zbritet sic e parashikon dhe ligji per formimin e rezervave te zakonshme. Kjo zbritje do te ndaloje se qenuri e detyrueshme atehere kur rezervat e zakonshme jane te barabarta ose te pakten sa nje e treta e kapitalit.
- b. Shuma e nevojitur per pagesen e dividendit te pare sic e parashikon ligji, qe do te jete e barabarte me te pakten gjashte per qind (6%) te aksioneve te paguara siaps nenit 45 te Ligjit 2190/1920 se bashku me Ligjin 876/1979, do te zbritet me pas.
- c. Bilanci duhet te jete i disponueshem lehtas nga Asambleja e Pergjithshme.

KAPITULLI VIII

Shperberja - Likuidimi

Neni 32

ARSYET E SHPERBERJES SE SHOQERISE

1. Shoqeria shperbehet:
 - a) kur skadon periudha e funksionimit te saj dhe Asambleja e Pergjithshme nuk ka caktuar nje date me te hershme skadimi ose nje kohezgjatje te saj.
 - b) ne baze te vendimit te Asamblese se Pergjithshme.
 - c) ne qofte se shoqeria deklarohet e falimentuar.
2. Grumbullimi i te gjitha aksioneve ne duart e nje njeriu perben shkak per shperberjen e shoqerise.
3. Keshilli Administrativ detyrohet qe brenda gjashte (6) muajsh nga shperberja te therrase Asamblene e Pergjithshme, dhe te vendosi nese duhet shperbere shoqeria apo

duhen marre masa te tjera ne rast se shuma e asetëve te shoqerise, sic percaktohet ne modelin e bilancit, qe parashikohet ne nenin 42 te Ligjit 2190/20 permiresuar me Dekretin Presidential 409/86, bie nen gjysmen e aksioneve te kapitalit.

Neni 33

LIKUIDIMI

1. Përvec rastit të falimentimit, shpërberja e shoqerise vazhdon me likuidimin e saj. Në rastin e parashikuar nga neni 32 pika a, të të njëjtit dokument, Keshilli Administrativ zbaton detyrat e likuiduesve deri sa të emrohen likuiduesit nga Asambleja e Përgjithshme. Në rastin e pikës b të nenit të mesipër të njëjtit paragraf dhe dokument, Asambleja e Përgjithshme, me anë të të njëjtit vendim percakton dhe likuiduesit, dy deri në katër nga aksionerët ose të tretë, të cilët do të kryejnë të gjitha detyrat e Keshillit Administrativ dhe që lidhen me procesin dhe qëllimin e likuidimit, sic atyre ju është percaktuar nga Asambleja e Përgjithshme vendimeve të secilës ata janë të detyruar të nënshtrohen. Emerimi i likuiduesve percakton fuqitë e anëtarëve të Keshillit Administrativ dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar.
2. Likuiduesit e zgjedhur nga Keshilli Administrativ detyrohen që kur marrin detyrën, të bëjnë inventarizimin e pronës së shoqerise dhe të publikojnë bilancin e likuidimit nëpërmjet shtypit dhe Fashikullit të Shoqerive Anonime dhe Shoqerive me Përgjegjësi të Kufizuar të Gazetës Zyrtare sipas pikës 1. të nenit 7a të Ligjit 2190/20 permiresuar me artikullin 7 të Dekretit Presidential 409/86. Kopje të bilancit të likuidimit do të dorëzohen pranë organeve kompetente të inspeksionit.
3. Të njëjtat detyrime mbajnë dhe likuiduesit deri në përfundimin e likuidimit.
4. Asambleja e Përgjithshme e aksionerëve do të ruajë të gjitha fuqitë përgjatë procesit të likuidimit.
5. Bilanci i likuidimeve do të aprovohet nga Asambleja e Përgjithshme e aksionerëve që gjithashtu do të vendosë për çlirimin e likuiduesve nga ndonjë detyrim ligjor.
6. Rezultatet e likuidimit do të dorëzohen çdo vit Asamblese së Përgjithshme, së bashku me një raport mbi shkaqet që kanë penguar përfundimin e këtij likuidimi.

KAPITULLI IX

Urdhëresat Tranzitore

Neni 34

MBULIMI DHE PAGESA E KAPITALIT

Kapitali i shoqerise arrin sipas nenit 5 të të njëjtit dokument në shumën në dhrahmi pesë milion (5,000.000) dhe vjen i gjithi nga kontributi i themeluesve të shoqerise që janë pale kontraktore në krijimin e kësaj kompanie si më poshtë:

1. Themeluesi Filimon Papapolyzos merr njëqind e pesëdhjetë e pesë (155) aksione me vlerë totale në dhrahmi një milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë (1,550.000) që paguan shumën perkatese me para në dorë.

2. Themelues Kristos Filimon Papapolyzos merr shtetehjete e pese (75) aksione me vlere totale ne dhrahmi shtateqind e pesedhete mije (750.000) qe paguan shumen perkatese me para ne dore.
3. Themelues Emanuil Filimon Papapolyzos merr shtetehjete e pese (75) aksione me vlere totale ne dhrahmi shtateqind e pesedhete mije (750.000) qe paguan shumen perkatese me para ne dore.
4. Martha e Bija e Filimonit Papapolyzos merr shtetehjete (70) aksione me vlere totale ne dhrahmi shtateqind mije (700.000) qe paguan shumen perkatese me para ne dore.
5. Sofia, bashkeshortja e Filimonit Papapolyzos merr shtetehjete e pese (75) aksione me vlere totale ne dhrahmi shtateqind e pesedhete mije (750.000) qe paguan shumen perkatese me para ne dore.
6. Shoqeria anonime me emrin "Shoqeri Informacioni OLYMPIC Sh.A. merr njezete e pese (25) aksione me vlere totale ne dhrahmi dyqind e pesedhete mije (250.000) qe paguan shumen perkatese me para ne dore.
7. Shoqeria anonime me emrin "DDB NEEDHAM WORLDWIDE S.A." merr njezete e pese (25) aksione me vlere totale ne dhrahmi dyqind e pesedhete mije (250.000) qe paguan shumen perkatese me para ne dore dhe

Ky kapital i shoqerise mbulohet plotesisht nga themeluesit ne shumen e siper permendur, dhe themeluesit/aksioneret do te marrin te gjitha aksionet qe ju perkasin sic u permend me siper.

NENI 35

Keshilli i pare Administrativ perbehet si me poshte:

1. Filimon Papapolyzos i biri i Kristos dhe i Stilianise i lindur ne Katafigon te Kardhices ne vitin 1923, reklamues, banor i Ekalit (Ikarias 4)
2. Kristos Papapolyzos i biri i Filimonit dhe Sofies, lindur ne Athine me 1957, reklamues, banor i Ekalit (Thiseos 14)
3. Emanuil Papapolyzos i biri i Filimonit dhe Sofies, lindur ne 1961 ne Athine, reklamues, banor i Ekalit (Ikarias 4)
4. Martha e bija e Filimonit dhe Sofia Papapolyzos lindur ne Athine ne 1966, reklamuese banore e Ekalit (Ikarias 4)
5. Sofia, e shoqja e Filimon Papapolyzos - e bija e Emanuil dhe Theodoras Gaxoflia, lindur ne Kozan ne vitin 1932, reklamuese, banore e Ekalit (Ikarias 4)
6. Marilena, basjkeshortja e Kristos Papapolyzos e bija e Haritonos dhe Vasiliki Korizi, zonje shtepie, lindur ne Athine ne 1961, Banore e Ekalit (Thiseos 14)
Te mesipermit jane me shtetesi dhe kombesi greke dhe
7. HENRI GODITIABOIS - DEACON, lindur ne Bruksel te Belgjikes ne vitin 1932, banor i Brukselit te Belgjikes, (rruga "BOULEVARD DE LA CAMBRE 33) mbajtes pasaporte Belge me numer 0249313/314/18.6.1985, shtetesi dhe kombesi Belge.

Keta do te administrojne shoqerine deri ne takimin e pare te Asamblese se Pergjithshme te aksionereve te saj qe do te therritet brenda gjashte-mujorit te pare te vitit 1990.

Neni 36

Eksperte kontabel te autorizuar per vitin e pare te perdorimit te shoqerise do te jene:

- 1) Ioanis Karahalios i Nikolles dhe Maries, banor i Athines (rruga Agio Konstandino nr.4) i lindur ne Athine ne vitin 1935 i diplomuar ne shkollen mekanike dhe
- 2) Kristos Keramitsoglou i Theodorit dhe Elisabetes, i lindur ne Dhidhimotikon, Evro, ne vitin 1959, Banues ne Athine (rruga Agios Konstandinou nr.4) i diplomuar ne ASOEE,

Personat qe do te zevendesojne te mesipermit jane:

- 1) Kristos Grigoropoulos, i Kostandinit dhe Marikes i lindur ne Spoliata te Agrinios ne vitin 1941, i diplomuar ne shkollen mekanike, banues ne Athine (rruga Agilis nr. 81) dhe
- 2) Panajotis Grekiotis i Aristomenit dhe Akrivos i lindur ne Andricena te Arkadies ne vitin 1926, banor i Athines (rruga Anteu nr.33) i diplomuar ne shkollen e biomekanikes

te gjitha te rregullt dhe plotesues me kombesi dhe shtetesi Greke.

Shperblimi per punen e seicilit prej tyre caktohet ne shumen prej njezet e pese mije Drahmi (Drh 25,000) per secilin.

Neni 37

Ne te gjitha rastet e paparashikuara nga statuti vihen ne perdorim urdheresat e Ligjit 2190/1920.

Neni 38

Palet kontraktuese te ketij statuti i japin detyre te vecante dhe autoritet te plote z. Grigoriou Antoniou Mourgelas, avokat, banor i Athines (rruga Vasilis Sofias 67) qe te parashtroje kete document per aprovim ne zyren e Prefektit dhe te perfaqesoje palet kontraktuese ne fjale para organeve perkatese me mandatin e posacem dhe me autoritet te plote perpara ligjit, qe ne rast heqje apo korrigjimesh te gabimeve te artikujve te mesiper dhe te plotesimeve dhe ndryshimeve te detyrueshme sipas ligjit ose qe ai i mendon te arsyeshme, pergjate procesit te aprovimit, te nenshkruaje te gjitha dokumentacionin noterial qe do te jete kontraktues per cfare shtohet ose rregullohet ne keto nene te statudit.

Γορκτηου.



STATUT I SHOQËRISE "DDB ALBANIA" SHA

Aksionerët e mëposhtëm themelojnë Shoqërinë "DDB ALBANIA" SHA në përputhje me Aktin e Themelimit të saj:

1. "OLYMPIC DDB (Holding)" S.A. themeluar më 14 janar 1988, me numër regjistri 16436/01AT/B/88/012 me seli në Rugën 12 Sorou, GR - 151 25, Amarousion, Athinë, Greqi.
2. Ardian Garo lindur më 8 korrik 1970, në Vrisera, Gjirokastrë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335698.
3. Pandeli Garo lindur më 6 Tetor 1964, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335699.
4. Admir Banaj lindur më 23 gusht 1963, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës AZ nr. 447932.

KAPITULLI I

KRIJIMI - FORMA - EMRI SELIA - KOHËZGJATJA - OBJEKTI

Neni 1 Aksionerët Themelues

1.1 Aksionerët themelues të shoqërisë janë:

1. "OLYMPIC DDB (Holding)" S.A.
2. Ardian Garo
3. Pandeli Garo
4. Admir Banaj

Neni 2 Forma Ligjore

2.1 Shoqëria krijohet në formën e shoqërisë anonime në bazë të ligjit Shqiptar "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 3 Selia

3.1 Selia e shoqërisë është në adresën Rruga "Donika Kastrioti", Vila nr.1/1, Tiranë, ALBANIA.

3.2 Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë zyra, filiale, agjenci ose të ofrojë shërbime në gjithë territorin e vendit me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të Aksionerëve.



Neni 4

Emri

4.1 Emri i shoqërisë është “DDB ALBANIA” SHA.

Neni 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, duke filluar që nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

5.2 Shoqëria mund të përfundojë para këtij afati ose ta zgjasë këtë afat me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, në përputhje me ligjin shqiptar.


Neni 6

Objekti

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Marrja përsipër dhe kryerja e çdo biznesi reklamues, prodhimi i materialeve reklamuese dhe ofrimi i shërbimeve reklamuese në përgjithësi;
- Marrja përsipër, kryerja dhe ofrimi i shërbimeve të marrëdhënieve për publikun, sponsorizimet, promocioneve të shitjeve dhe shërbime të komunikimit në përgjithësi.
- Marrja përsipër dhe kryerja e çdo veprimtarie tjetër në përmbushje të objektivave dhe veprimtarive të mësipërme.
- Kryerje studimesh dhe ofrim këshillash dhe shërbimesh në çështje organizimi, trainim personeli dhe funksionimi më efektiv të ndërmarrjeve dhe organizatave që janë në funksionim ose parashikohet të krijohen në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe çështje që kanë të bëjnë me plane investuese të këtyre shoqërive.
- Ofrim shërbimesh këshillimore financiare, investimesh, komunikimi dhe zhvillimi dhe në përgjithësi dhënia e shërbimeve këshilluese të të gjitha llojeve, natyrave dhe përmbajtjeve për persona fizikë dhe juridikë ose/dhe organeve të pushtetit lokal ose/dhe shtetit.
- Ofrim i shërbimeve të blerjeve dhe “central bying”.
- Ofrim shërbimesh menaxhimi, tatimi, financiare, kompjuterizimi, organizimi dhe mbështetje dhe në përgjithësi shërbime personeli, udhëzim metodash të rritjes së shitjeve dhe administrimi financiar si dhe në përgjithësi ofrimi i shërbimeve të organizimit, drejtimit dhe administrimit të ndërmarrjeve.
- Ortakëri, dhe/ose drejtim ndërmarrjesh të tjera me anë të blerjes së aksioneve.

6.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.



6.3 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.

6.4 Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj.

KAPITULLI II

KAPITALI – AKSIONET

Neni 7 Kontributet

7.1 Në çastin e krijimit të shoqërisë, kapitali themeltar i shlyer në lekë është 2 000 000 (dy milion).

7.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 2 000 aksione që kanë një vlerë nominale prej 1000 (një mijë) lekë secili. Aksionet janë të pandashme.

7.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht prej aksionerëve:

1. "OLYMIPC DDB (Holding)" S.A. zotëron 1 200 aksione (60 për qind të kapitalit aksioner) që i korrespondon shumës prej 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë.
2. Ardian Garo zotëron 420 aksione (21 për qind të kapitalit aksioner) që i korrespondon shumës prej 420 000 (katërqind e njëzetë mijë) lekë.
3. Pandeli Garo zotëron 280 aksione (14 për qind të kapitalit aksioner) që i korrespondon shumës prej 280 000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
4. Admir Banaj zotëron 100 aksione (5 për qind të kapitalit aksioner) që i korrespondon shumës prej 100 000 (njëqind mijë) lekë.


Neni 8 Zmadhimi i Kapitalit

8.1 Kapitali themeltar zmadhohet vetëm me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionerëve mbi bazën e raportit të Drejtorisë. Statuti i shoqërisë ndryshohet në përputhje me këtë rritje.

8.2 Kapitali mund të rritet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese. Aksionet e reja shlyhen më para në dorë ose me kontribut në natyrë.

8.3 Aksionerët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin e aksioneve për rritjen e





kapitalit. E drejta e përparësisë ushtrohet në raport me aksionet që zotëron çdo aksioner në çastin e rritjes së kapitalit. Aksionerët mund të heqin dorë personalisht nga e drejta e nënshkrimit të aksioneve të reja.

8.4 Në rastin e rritjes së kapitalit me kontribute në natyrë, me vendim gjykate caktohet një ekspert për kontributet në përputhje me nenet 162, 168, 169 të ligjit të shoqërive.

8.5 Rritja e kapitalit duhet të përfundojë brenda 5 (pesë) vjetëve nga data e Asamblesës së Aksionerëve që ka marrë një vendim të tillë (neni 153 i ligjit të shoqërive).

Neni 9 Zvogëlimi i Kapitalit

9.1 Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, por në një rast të tillë zvogëlimi i prek të gjithë aksionerët proporcionalisht me aksionet që zotërojnë në shoqëri në bazë të nenit 164 i ligjit të shoqërive.

9.2 Drejtoria i dorëzon Asamblesë së mbledhur për marrjen e një vendimi mbi zvogëlimin e kapitalit një raport të arsyetuar i cili përshkruan rrethanat që kanë bërë të detyrueshme zvogëlimin e kapitalit.

9.3 Zvogëlimi i kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar të paktën 45 (dyzetë e pesë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme që thirret për të vendosur mbi zvogëlimin e kapitalit.

Neni 10 Shlyerja dhe Verifikimi i Kapitalit

10.1 Kapitali themeltar i shoqërisë duhet të jetë shlyer plotësisht, në qoftë se realizohet zmadhimi i kapitalit aksioner me para në dorë. Në rast të kundërt, rritja e kapitalit dhe emetimi i aksioneve të reja konsiderohen të pavlefshme sipas nenit 154 të ligjit të shoqërive.

10.2 Në rast të rritjes së kapitalit, Këshilli Mbikqyrës duhet që brenda një afati 3 (muaj) nga zmadhimi i kapitalit të verifikojë depozitimin e kapitalit.

Neni 11 Aksionet

11.1 Aksionet janë nominale. Për aksionet do të lëshohen tituj transferimi në bazë të ligjit, tipi i të cilave vendoset nga Këshilli Mbikqyrës i cili përcakton personat që do të firmosin titujt. Aksionet nonimale u transferohen të tretëve në bazë të nenit 198 të ligjit të shoqërive. Në çastin e themelimit të shoqërisë ose gjatë ekzistencës së saj, shoqëria mund të emetojë aksione me përparësi të cilat kanë avantazhe në raport me gjithë aksionet e tjera, sipas nenit 148, 149 të ligjit të shoqërive.

11.2 Aksionet janë të pandashme. Ato kanë vetëm një pronar kryesor. Çdo aksion jep



të drejtën e një vote. Në rast se një aksion zotërohet nga më shumë se një pronar, atëherë të drejtat e tyre ushtrohen nga një përfaqësues, në të kundërt, aksioni nuk përfaqësohet dhe ushtrimi i të drejtave që vijnë si pasojë e tij pezullohet.

11.3 Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetëm prurësi i ligjshëm.

Neni 12 Transferimi i Aksioneve

12.1 Në rastin kur një aksioner dëshiron të transferojë të gjitha ose një pjesë të aksioneve të tij, është i detyruar të njoftojë më shkrim Këshillin Mbikqyrës, duke i bërë të ditur vlerën e aksioneve me qëllim që aksionerët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Këshilli Mbikqyrës njofton me shkrim aksionerët e tjerë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për një transferim të tillë.

12.2 Aksionerët e tjerë duhet të njoftojnë Këshillin Mbikqyrës brenda 3 (tre) muajve nëse ata do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes apo jo.

12.3 Në rast se numri i aksionerëve që dëshirojnë të blejnë aksione është më i madh se një, ata do të marrin aksione në përpjesëtim me numrin e aksioneve që zotërojnë. Transferimi i aksioneve në ndryshim me sa është parashikuar në këtë nen do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të prodhojë efekte ligjore për shoqërinë.

Neni 13 Të Drejtat dhe Detyrimet që lidhen me Aksionet

13.1 Çdo aksion i jep të drejtën zotëruesit të tij të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë në raport me aksionet që ai/ajo përfaqëson dhe në rast likuidimi të drejtën e pjesëmarrjes në asetet e mbetura të shoqërisë.

13.2 Aksionerët janë përgjegjës deri në vlerën nominale të aksioneve të tyre.

13.3 Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga aksionet ndjekin aksionet pavarësisht nga transferimi i tyre.

KAPITULLI III

ORGANET KOMPETENTE

Neni 14 Asambleja e Aksionerëve

14.1 Asambleja e Aksionerëve është organi më i lartë i shoqërisë. Ajo vendos mbi të gjitha çështjet e shoqërisë dhe vendimet e saj janë detyruese për aksionerët.

14.2 Vetëm Asambleja e shoqërisë ka të drejtën të ndryshojë Statutin me të gjitha dispozitat e tij. Çdo kufizim tjetër është i pavlefshëm.



14.3 Asambleja e Jashtëzakonshme e shoqërisë mund të marrë vendime të vlefshme me 50 për qind të kapitalit aksioner në mbledhjen e saj të parë në rast se nuk ekziston shumica e kërkuar, Asambleja mund të shtyhet, por jo më shumë se dy muaj nga data e mbledhjes së parë. Në një rast të tillë, Asambleja është e vlefshme nëse 25 për qind e kapitalit aksioner është i pranishëm ose i përfaqësuar. Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të marrë vendime me $\frac{3}{4}$ e votave të kapitalit aksioner të pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 15 Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e Aksionerëve

15.1 Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve ka të drejtën të marrë çdo vendim me përjashtim të atyre vendimeve që parashikohen në nenin 128 të ligjit të shoqërive të cilat janë në diskrecionin e Asamblesë së Jashtëzakonshme.

15.2 Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve merr vendime përfundimtare mbi çështjet që lidhen me shoqërinë. Vendimet janë të vlefshme nëse në mbledhjen e parë marrin pjesë personalisht ose përfaqësohen aksionerët që zotërojnë të paktën $\frac{1}{4}$ e kapitalit aksioner me të drejtë vote. Në rast se nuk arrihet shumica në këtë mbledhje, në mbledhjen e dytë nuk kërkohet asnjë shumicë.

15.3 Vendimet e Asamblesë së Zakonshme merren me shumicën e thjeshtë të votave të aksionerëve të pranishëm.

15.4 Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve thirret një herë në vit brenda 6 (gjashtë) muajve të parë të mbylljes së vitit financiar. Një afat i tillë mund të zgjatet me vendim gjykatë.

15.5 Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve merr në shqyrtim dhe vendos për të gjitha çështjet e vitit financiar që u mbyll, sipas dispozitave të ligjit të shoqërive.

Neni 16 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve

16.1 Ndryshimi i Stautit të shoqërisë është kompetencë e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë.

16.2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të marrë vendime vetëm në rast se në mbledhjen e parë marrin pjesë personalisht ose janë të përfaqësuar aksionerët që zotërojnë të paktën $\frac{1}{2}$ e aksioneve me të drejtë vote dhe në mbledhjen e dytë $\frac{1}{4}$ e tyre. Në rast se nuk mbahet mbledhja e parë, e dyta duhet të mbledhet jo më vonë se 2 (dy) muaj nga dita e mbledhjes së parë.

16.3 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve merr vendime me shumicën absolute të votave, d.m.th. me $\frac{3}{4}$ e votave të aksionerëve pjesëmarrës.



Neni 17**Modalitetet e Thirrjes**

17.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve thirret nga Këshilli Mbikqyrës ose Drejtoria. Në mungesë të tyre, mund të thirret nga:

- 1) Eksperti Kontabël i Autorizuar;
- 2) Personi i autorizuar nga gjykata mbi kërkesën e çdo të interesuari në një rast urgjent ose të një ose disa aksionerëve që së bashku zotërojnë 1/10 e kapitalit;
- 3) Likuidatori;

17.2 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve thirret në mënyrën e parashikuar nga ligji.

17.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve mbahen në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër në territorin e Shqipërisë ose jashtë saj.

Neni 18 Vlefshmëria e Vendimeve

18.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve merr vendime të vlefshme edhe kur procedurat e thirrjes nuk janë respektuar, në qoftë së të gjithë aksionerët janë prezent ose të përfaqësuar.

18.2 Nje aksioner mund të përfaqësohet vetëm nga një aksioner tjetër ose nga bashkëshorti ose bashkëshortja.

Neni 19 E Drejta e Informacionit

19.1 Drejtoria është e detyruar të vërë në dispozicion të aksionerëve përpara mbledhjes së Asamblesë, të gjitha dokumentet që parashikon ligji i shoqërive.

19.2 Çdo aksioner ose përfaqësuesi i tij ka të drejtën të marrë informacion mbi të gjitha çështjet e parashikuara në ligjin e shoqërive, në selinë e tyre, duke filluar nga momenti i marrjes njoftim i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Në mënyrë të veçantë, ata kanë të drejtën për të marrin informacion për:

- regjistrat, bilancet, listat e antarëve të Drejtorisë dhe të Këshillit Mbikqyrës;
- raportet e Drejtorisë, të Këshillit Mbikqyrës dhe Ekspertit Kontabël të autorizuar;
- shumën e saktë të shpërblimeve të personave të mësipërm.

19.3 Çdo aksioner ka të drejtën të marrë informacion ose kopje të listës së aksionerëve dhe antarëve të Këshillit Mbikqyrës 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.

19.4 Nëse shkelet e drejta për të marrë informacion e aksionerëve, ata kanë të drejtën t'i drejtohen gjykatës.



Neni 20 Kërkesa për të Marrë pjesë në Mbledhje

20.1 Aksionerët që duan të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme duhet të dorëzojnë aksionet e tyre ose një çertifikatë bankare të depozitimit të aksioneve pranë një banke.

Neni 21 Përfaqësuesi i Aksionit

21.1 Në rast se një aksion mbahet nga më shumë se një person, ata duhet të caktojnë një përfaqësues i cili ka të drejtën të ushtrojë të drejtat e aksionerëve.

Neni 22 Pjesëmarrës të Tjerë

22.1 Antarët e Këshillit Mbikqyrës, të Drejtorisë dhe eksperti kontabël mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve dhe kanë vota konsultative. Nëse ata janë aksionerë, vota e tyre është vendosëse.

Neni 23 Librat

23.1 Emrat e atyre që marrin pjesë në Asambletë e Përgjithshme të Aksionerëve regjistrohen në "Librin e Pjesëmarrësve".

23.2 Për mbledhjet mbahet procesverbal.

Neni 24 Kryetari i Këshillit Mbikqyrës

24.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve drejtohet nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ose në mungesë të tij nga zëvendësi i tij ose nga një person i zgjedhur nga antarët e pranishëm.

Neni 25 Të Drejtat e Minoritetit

25.1 Aksionerët që zotërojnë 1/10 e kapitalit aksioner mund të thërrasin Asamblenë e Jashtëzakonshme të Aksionerëve duke përcaktuar dhe rendin e ditës. Këshilli Mbikqyrës është i detyruar ta thërrasë Asamblenë e Jashtëzakonshme të Aksionerëve kur kërkohet, përveç rastit kur ekziston një arsye e rëndësishme. Aksionerët që zotërojnë 1/10 e kapitalit aksioner mund t'i drejtohen gjykatës për ekzistencën e arsyes së rëndësishme dhe të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme.

25.2 Aksionerët që zotërojnë 1/10 e kapitalit aksioner mund të kërkojnë nga Kryetari i Asamblesë të pezullojë marrjen e një vendimi nga Asambleja e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme vetëm një herë, duke përcaktuar ditën e mbledhjes tjetër e cila nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) ditë nga dita e pezullimit të mbledhjes së parë.



Neni 26 Këshilli Mbikqyrës

26.1 Këshilli Mbikqyrës është organi që drejton shoqërinë. Ai përbëhet nga 3 (tre) antarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve. Një e treta e antarëve duhet të emërohet nga të punësuarit në shoqëri. Anetarët e Këshillit Mbikqyrës janë:

1. Christos Papapolyzos (kryetar)
2. Apostolos Fotopoulos (antar)
3. Pandeli Garo (antar)

26.2 Antarët e Këshillit Mbikqyrës të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme mund të mos jenë të punësuar në shoqëri.

26.3 Kryetar i Këshillit Mbikqyrës është Christos Papapolyzos.

Neni 27 Antarët

27.1 Antarët e Këshillit Mbikqyrës mund të mos jenë aksionerë. Antarët e Këshillit Mbikqyrës nuk kanë përgjegjësi personale kundrejt të tretëve dhe aksionerëve të shoqërisë. Ata mbajnë përgjegjësi kundrejt shoqërisë për detyrat që u janë ngaruar.

27.2 Antarët e Këshillit Mbikqyrës qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh e cila mund të përtërihet dhe për një periudhë tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të thirrur për miratimin e deklaratave financiare të vitit financiar që u mbyll.

27.3 Këshilli Mbikqyrës cakton një kryetar dhe zëvendësin e tij. Kryetari dhe në mungesë të tij zëvendësi, drejton mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës.

27.4 Në rast vdekjeje, largimi ose mungese të paarsyeshme nga tre mbledhje të njëpasnjëshme, Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një zëvendës deri në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Aksionerëve.

Neni 28 Mbledhjet

28.1 Këshilli Mbikqyrës mbledhet nga Kryetari ose në mungesë të tij nga zëvendësi, ose në raste të tjera nga të paktën 2 (dy) antarë të tij.

28.2 Këshilli Mbikqyrës merr vendime me shumicën e thjeshtë të votave të antarëve të tij të pranishëm.

28.3 Këshilli Mbikqyrës ka një shumicë dhe mbledhet ligjërisht kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar 50 për qind plus një e antarëve të tij. Antarët që mungojnë nga Këshilli Mbikqyrës mund të përfaqësohen vetëm nga një antar tjetër i Këshillit Mbikqyrës.



Neni 29 Vendimet

29.1 Diskutimet dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës mbahen në procesverbale të cilat firmosen nga antarët e pranishëm së bashku me mendimet e kundërta të atyre që nuk janë dakord.

29.2 Këshilli Mbikqyrës ka kompetencën të vendosë për të gjitha çështjet e drejtimit të shoqërisë, administrimin e pasurive të saj dhe realizimin e qëllimeve të shoqërisë. Këshilli mbikqyrës nuk ka të drejtë të vendosë për çështje për të cilat janë në kompetencë të Asamblesë së Aksionerëve.

29.3 Këshilli Mbikqyrës mund të delegojë me shkrim përfaqësimin e shoqërisë dhe/ose të kmpetencave të saj tek një ose disa antarë ose palë të treta, duke përcaktuar dhe kompetencat e deleguara.

29.4 Antarët e Këshillit Mbikqyrës përfitojnë shpërblim i cili vendoset nga Asambleja e Aksionerëve.

Neni 30 Drejtoria

30.1 Antarët e Drejtorisë emërohen nga Këshilli Mbikqyrës.

30.2 Antarët e Drejtorisë mund të mos jenë aksionerë në shoqëri dhe nuk duhet të jenë antarë të Këshillit Mbikqyrës. Antarët e Drejtorisë janë persona fizikë.

30.3 Drejtoria përbëhet nga 1 (një) antar.

30.4 Një nga antarët e Drejtorisë emërohet nga Këshilli Mbikqyrës në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë.

30.5 Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë është z. Ardian Garo.

Neni 31 Mandati i Antarëve të Drejtorisë

31.1 Antarët e Drejtorisë qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh.

31.2 Në rast të vendeve vakante, plotësimi duhet të bëhet brenda 2 muajve. Nëse plotësohet vendi vakant, zëvendësi qëndron në detyrë deri në emërimin e një Drejtorise së re.

31.3 Këshilli Mbikqyrës për shkaqe të arsyeshme mund të shkarkojë antarët e Drejtorisë.



Neni 32 Funksionimi

32.1 Antarët e Drejtorisë mund t'i ndajnë detyrat e tyre duke patur miratimin paraprak të Këshillit Mbikqyrës. Drejtoria duhet të informohet periodikisht për vendimet e antarëve të saj.

32.2 Drejtoria në marrëdhënie me palët e treta përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 33 Mbledhjet e Drejtorisë

33.1 Drejtoria mbledhet në çdo kohë që e kërkon interesi i shoqërisë. Mbledhjet e Drejtorisë thirren nga Drejtori i Përgjithshëm ose nga një prej drejtorëve të tjerë. Njoftimi bëhet me shkrim me postë, e-mail, faks, telefaks, teleks ose në ndonjë mënyrë tjetër.

33.2 Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë dhe drejtohen nga Drejtori i Përgjithshëm ose drejtori që thërret mbledhjen.

33.3 Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave. Nuk lejohet votimi nëpërmjet përfaqësuesve.

Neni 34 Kompetencat

34.1 Drejtoria ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, me kusht që këto kompetenca nuk janë në diskrecionin e Asamblesë së Përgjithshme ose Këshillit Mbikqyrës.

34.2 Drejtoria ushtron kompetencat e saj brenda kufijve të objektit të shoqërisë.

34.3 Në rast të transaksioneve që kërkojnë autorizimin e Këshillit Mbikqyrës dhe ky i fundit nuk e jep atë, Drejtoria mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme dhe t'ia paraqesë çështjen për shqyrtim.

34.4 Drejtoria përgatit raportet dhe rendin e ditës së mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikqyrës.

34.5 Drejtoria, brenda 3 muajve nga dita e mbylljes së vitit financiar, përgatit dhe i paraqet Këshillit Mbikqyrës llogaritë vjetore dhe raportet vjetore të veprimtarisë financiare të shoqërisë për t'i verifikuar dhe kontrolluar.

KAPITULLI IV

KONTROLI I SHOQËRISË



Neni 35 Ekspertët Kontabël

35.1 Asambleja e Përgjithshme emëron ekspertët kontabël të cilët kanë të drejtën të:

- Ndihmojnë në mbajtjen e llogarive me qëllim që të jenë në përputhje me parimet kryesore të kontabilitetit;
- Përgatitin raportet vjetore me të dhëna ekonomike (bilancet, llogaritë e fitimit dhe humbjeve dhe dokumente të tjera që lidhen me to) dhe japin mendimet e tyre nëse të dhënat ekonomike reflektojnë gjendjen ekonomike aktuale të shoqërisë.
- Informon Këshillin Mbikqyrës mbi çdo parregullsi të mundshme të vënë re në procedura, asetet e shoqërisë që mund të kenë shkaktuar humbje për shoqërinë.

Neni 36 Kompetencat

36.1 Ekspertët kontabël qëndrojnë në detyrë për periudhë prej 1 (një) viti.

36.2 Eksperti kontabël është i detyruar të mbikqyrë llogaritë vjetore të janë përpiluar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin” dhe përmbajnë rezultatet e periudhës ushtrimore dhe japin rezultatin e plotë të vitit financiar që u mbyll. Eksperti kontabël ka kompetencat që parashikohen në ligjin e shoqërive

36.3 Nëse eksperti kontabël nuk i kryen detyrat e tij ashtu siç duhet, ai mund të pezullohet nga detyra me vendim gjyqi i cili mblidhet dhe vendos me procedurë urgjente.

36.4 Eksperti i parë kontabël i shoqërisë është z. Kosta Nika.

Neni 37 Librat e Shoqërisë

37.1 Shoqëria duhet të mbajë librat e kërkuar nga ligji në të cilët regjistrohen llogaritë vjetore, deklaratat financiare vjetore, bilancet vjetore, raportet ekonomike vjetore të cilët duhet të përmbijnë çdo gjë që parashikohet nga ligji.

37.2 Librat e shoqërisë si dhe pasqyrat financiare, bilancet vjetore dhe raportet financiare vjetore mbahen si në gjuhën Shqipe ashtu dhe në atë Greke.

Neni 38 Viti Financiar

38.1 Viti financiar ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar që nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në gjykatë dhe mbaron në 31 Dhjetor 2000.

38.2 Këshilli Mbikqyrës mbikqyr llogaritë vjetore që të jenë në përputhje me ligjin



“Për Kontabilitetin” dhe harton raportin mbi administrimin.

Neni 39 Rezerva e Domosdoshme Ligjore

39.1 Rezerva e domosdoshme ligjore krijohet nga të paktën 5 për qind e fitimit neto që mbetet pas zbritjes së humjeve të viteve të kaluara. Një procedurë e tillë nuk është e detyrueshme kur fondi rezervë bëhet sa 1/10 e kapitalit aksioner.

Neni 40 Ndarja e Fitimit

40.1 Fitimi llogaritet si rezultat i fitimit të bilancit duke i zbritur rezervën e domosdoshme dhe humbjet e viteve të kaluara sipas nenit 40.

Neni 41 Dividendët

41.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe llogarotjen e shumës që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme përcakton shumën që do tu jepet aksionerëve si dividend në bazë të neneve 215, 216 të ligjit të shoqërive.

KAPITULLI V

PRISHJA

Neni 42 Prishja

42.1 Shoqëria priset nëse ka mbruar kohëzgjatja e sj ose në rast se ka shpallur falimentimin.

Neni 43 Likuidimi

43.1 Shoqëria likuidohet në përputhje me dispozitat ligjore për falimentimin.

43.2 Shoqëria bën likuidimin në çastin e prishjes së saj për çfarëdolloj arsyeje me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 10 të ligjit të shoqërive.

43.3 Gjatë likuidimit, emri i shoqërisë ndiqet nga shprehja “në likuidim”. Ky emër si dhe emri i likuidatorit duhet të pasqyrohen në të gjitha veprimet dhe dokumentet e lëshuara nga shoqëria tek të tretët.

KAPITULLI VI

Neni 44 Dispozita të Përgjithshme

44.1 Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi për Shoqëritë Anonime pa ofertë publike.



44.2 Ky statut është hartuar në 8 (tetë) kopje në gjuhën shqipe dhe 8 (tetë) në gjuhën angleze dhe pasi iu lexua aksionerëve u nënshkrua prej tyre.

44.3 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj pas marrjes së miratimit nga organet Shqiptare kompetente në bazë të ligjit shqiptar në fuqi.

AKSIONERËT

1. Për shoqërinë "OLYMPIC DDB (Holding)" S.A. *Ardian Garo*
Përfaqësuesi me prokurë Ardian GARO

2. Per Z. Pandeli GARO *Pandeli Garo*
Përfaqësuesi me prokurë Ardian GARO

3. Ardian GARO *Ardian Garo*

4. Admir BANAJ *Admir Banaj*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 1301 REP.
NR. 183 KOL.

VËRTETIM

Sot më datë 18 dhjetor 2000 para meje *Dominik Noves*: notere e Dhomës së Notereve Tiranë, u paraqitën personalisht:

- Ardian Garo lindur më 8 korrik 1970, në Vrisera, Gjirokastrër, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335698.
- Admir Banaj lindur më 23 gusht 1963, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës AZ nr. 447932.

Të gjithë madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, të cilët në cilësinë e aksionerëve të shoqërisë "DDB ALBANIA" SHA Tiranë më paraqitën këtë Statut dhe pasi e nënshkruan atë rregullisht para meje, unë noterja e vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.



NOTERE

Dominik Noves

GAZETA ZYRTARE E QEVERISË SE REPUBLIKËS GRIKE
ΕΠΙΧΕΙΡΗΣΙΑΚΑ ΔΕΛΤΙΑ

SHOQËRITË ANONIME
STATUTET

Shpallim i regjistrimit në regjistrin e shoqërive anonime të përshtatjes të statutit të Shoqërisë Anonime me emërtimin "OLYMPIC IDIB NEEDHAM KONIPANI NDERKOMBETARE REKLAMASH"

PREFEKTI I ATHINËS

Me 27.4.2000 u regjistrua në regjistrin e shoqërive anonime të shërbimit tona në vendimin nr 3064 77.4.2000 me të cilin aprovohet përshtatja e nenëve 1 dhe 3 të statutit të shoqërisë anonime me emërtimin "OLYMPIC IDIB NEEDHAM KONIPANI NDERKOMBETARE REKLAMASH SUIA" dhe në regjistrin shpallim i regjistrimit nr 2755 në gazetën zyrtare të Asamblesës së Përgjithshme të aksionereve të datës 20 Mars

Të shihet që të aprovuan janë si më poshtë:

Neni 3

Qëllimi

1. Qëllimi i kompanisë është si më poshtë:
 - a. Lëvizje studimesh dhe ofrim këshillash dhe shërbimesh në çështje organizimi, trajnim personeli dhe funksionimi me efektiv të ndërmarrjeve dhe organizatave që janë në funksion ose parashikohet të llojëhen në Evropë dhe jashtë, si dhe çështje që kanë të bëjnë me planin investues të këtyre shoqërive.
 - b. Ofrim shërbimesh këshillatari financiar, investimesh, komunikimi dhe zhvillimi dhe në përgjithësi dhënia e shërbimeve këshilluese të të gjitha llojeve karaktereve dhe përmbajtje për persona fizike dhe juridike ose dhe organeve të pushtetit lokal ose dhe shtetit.
 - c. Kryerja shërbimesh blerje dhe dhënie shërbimesh "central buying".
 - d. Ofrim shërbimesh menaxhimi, tatimi, financiar, kompjuterizimi, organizimi dhe mbështetje dhe në përgjithësi shërbime personeli, udhëzim metodash të riutjes së shifjeve dhe administrimi financiar si dhe në përgjithësi ofrimi i shërbimeve të organizimit drejtimit dhe administrimit të ndërmarrjeve.
 - e. Ortakeri, dhe ose drejtim ndërmarrjesh të tjera me anë të blerjes së aksioneve dhe ose pjesëve të tyre në Greqi dhe jashtë.
 - f. Marrje dhe kryerje të çdo lloji veprimi për aktivitetete përshkruar më lart.
2. Për këtë qëllim kompania mund të themelojë degë agjensi ose zyra në Greqi dhe të përfshijë firma të huaja.
3. Me vendim të Asamblesës së Përgjithshme dhe përshtatje të kushtit që për shkaktohet nga çdo kryhet në mënyrë të ligjshme është e mundur të zgjerohet qëllimi i kompanisë.

NENI 1

TRUMBELLARI

Emërtimi shoqëri anonime me emërtimin "OLYMPIC IDIB SHOQËRI ANONIME DHE NE SHËRBIMESH DHE ORTAKERISHT"

Agja Parashqevi 27 Prill 2000

Me ordhër të Prefektit

Drejtoresha

Parashqevi Magulla



REPUBLIKA ZYRE E QEVERITË SE REPUBLIKËS ÇEKËRE
BASHKËLITËSIA DHE SËDPK

Janar 1988

SHOQERITE ANONIME
STATUTET

Numeri i Faqes
78

Permbajtja
Shoqerite Anonime
Statutet

Njoftimi i regjistrimit ne regjistrin e shoqerive anonime te pashtrikes te statutit te Shoqerise Anonime me emertimin "OLYMPIC DDB NEEDHAMI KOMPANI NDERKOMBETARE REKLAMASHI SLLA." dhe me emer dallues "OLYMPIC" DDB NEEDHAM

Ne 11.1.1988 u regjistruan ne regjistrin e shoqerive anonime e shqiptare te shqiptare te shqiptare me emertimin "OLYMPIC DDB NEEDHAMI KOMPANI NDERKOMBETARE REKLAMASHI SLLA." si dhe me vendim numer 31034/87 11.1.1988 te Kryetarit te Bashkise se Athines me te cilen ju dha leje per peshatjen dhe te aprojua statuti i kesaj kompanie ashtu sic u formua me ne 19968 3.12.1987 krye nga Nofra I Athine Vasilioe Dredhorn Firat dhe me nomen kompani "DDB" 8.1.1988 te neqit avokate.

Permbajtja e statuit vijon si me poshte:

1. Emertimin dhe emer dallues "OLYMPIC DDB NEEDHAMI KOMPANI NDERKOMBETARE REKLAMASHI SLLA." dhe sipas emer dallues "OLYMPIC" DDB NEEDHAM
2. Zyra: BASHKIAE ATHINES

Objekti: Objekti i kompanise eshte se me poshte ar marrja dhe prodhimi me te gjitha menyra te reklamave, prodhimi i mjetave reklamuese, den tel, vete paraqitja e sherbimeve te reklamave, hy marrja dhe prodhimi me te gjitha menyra dhe coherent, me qellim arrijen e objektivave te meshqerit te vyprimarise. Per kete qellim duhet te noren detyra, detyra dhe zyra ne Greqi dhe Gjyre dhe te shqiptare shqiptare te huaj.

Perfundimisht Kompania duhet te ndenteje dhe te marre pjese ne ndamarrje te tjera duke synuar arrijen e qellimit te shprehtur. Sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme dhe ndryshimeve te ligjshme eshte mundur te zgjerohen qellimet e saj tani me ne Kompanine e rekomanduuar

1. Kohezgjatja: Pesembjedhete (15) vjet
5. Sasia dhe menyra e pageses se aksioneve te kapitalit. Pesë Milion (5,000,000) drahmi.
6. Aksione (numer, lloji, emertimi, vlera) peseqind (500), aksione nominale, vlera e shprehtur ne drahmi dhjetë milion (10,000) seicila.
7. Data e skadimit te perdorimit te kompanise: Perdorimi i kompanise fillon me 1.1.1988 (1) Janar dhe skadon me tridhjetë e nje (31) Dhjetor te skadimit i parë i kompanise skadon me tridhjetë e nje (31) Dhjetor 1989.

8. Kuancaçi pjestareve të E. A. dhe zgjedhja e tyre: Pise deri në njëmbëdhjetë (15) të anetarëve në shkëlqim katër (4) vjeçar.

9. K. X. Epore dhe zgjedhja e tyre:

- 1) Filimon Papapolyzos i biri i Kristos dhe i Stilianise i lindur në Kataligon të Kardhices në vitin 1923, reklamues, banor i Ekalit (Ikarias 4)
- 2) Kristos Papapolyzos i biri i Filimonit dhe Sofies, lindur në Athinë në 1957, reklamues, banor i Ekalit (Thiseos 14)
- 3) Emanuel Papapolyzos i biri i Filimonit dhe Sofies, lindur në 1961 në Athinë, reklamues, banor i Ekalit (Ikarias 4)
- 4) Martha e bija e Filimonit dhe Sofies - Eulas Papapolyzos lindur në Athinë në 1966, reklamuese-banore e Ekalit (Ikarias 4)
- 5) Sofia, e shoqja e Filimon Papapolyzos - e bija e Emanuel dhe Theodoros Vaxothia, lindur në Kozani në vitin 1932, reklamuese, banore e Ekalit (Ikarias 4)
- 6) Marilena, bashkeshortja e Kristos Papapolyzos e bija e Haritonos dhe Vasiliki Korizi, zonjë shtëpie, lindur në Athinë në 1961, Banore e Ekalit (Thiseos 14)

Te mesipërmit janë me shtetësi dhe kombësi greke dhe

- 7) HENRI GODDUFAROS - DELACON, lindur në Bruksel të Belgjikës në vitin 1932, biznesmen dhe banor i Brukselit të Belgjikës, (ruga "BOULEVARD DE LA CAMBRE" 33) shtetësi dhe kombësi Belge mbajtës pasaportë Belge me numër 0249313 314 18,6,1985. Anëtarësia e tij vazhdon deri në taktimin e parë të Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve të kompanisë që do të themësi brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 1990.

10. Kontrollori për vitin e parë të përdorimit të kompanisë:

Te rregullt zotërimjtë:

- 1) Ioanis Karahaliou i Nikollës dhe Menies, banor i Athinës (ruga Agio Konstandino nr.4) i lindur në Athinë në vitin 1935 i diplomuar në shkollën mekanike dhe
- 2) Kristos Keramiroglou i Theodorit dhe Elisabetes, i lindur në Dhidhimotikon, Evro, në vitin 1959, famull në Athinë (ruga Agios Konstandinou nr.4) i diplomuar në ASOIE.

Za vendesues zotërimjtë:

- 1) Kristos Grigorepoulos, i Kostandinut dhe Marikos i lindur në Spoliati të Agrinios në vitin 1941, i diplomuar në shkollën mekanike, banues në Athinë (ruga Agilis nr. 81) dhe
- 2) Panajotis Grekiotis i Aristomenit dhe Akrivos i lindur në Andricena të Arkadies në vitin 1926, banor i Athinës (ruga Anteu nr.33) i diplomuar në shkollën e biomekanikës të gjithë të përditshëm dhe plotësues me kombësi dhe shtetësi Greke.

Athinë 14 janar 1988

Me urdher të Kryetarit të Bashkisë

Drejtori

N. NIRVELAKIS

3

3 M. Dajti
19.12.2000
19 DIC. 2000

KERKESE PER REGJISTRIM PERSONI JURIDIK

Kerkuesi: Shoqeria "DDB ALBANIA" SHA

Objekti: Regjistrimi i personit juridik "DDB ALBANIA" SHA

Baza ligjore: Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe Ligji Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"


24894

To be registered
shoqeria
banuar ne
Gjykates se Rrethit Tirane

Shoqeria "DDB ALABNIA" SHA themelohet si shoqeri e se drejtes shqiptare nga aksioneret a) "OLYMPIC DDB (Holding)" S.A. themeluar me 14 janar 1988, me numër regjistrimi 16436/01AT/B/88/012 me seli në Rrugën 12 Sorou, GR – 151 25, Amarousion, Athinë, Greqi; b) Ardian Garo lindur më 8 korrik 1970, në Vrisera, Gjirokastër, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335698; c) Pandeli Garo lindur më 6 Tetor 1964, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335699; d) Admir Banaj lindur më 23 gusht 1963, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës AZ nr. 447932.

Shoqeria "DDB ALBANIA" SHA do te kete formen e shoqerise anonime. Selia e shoqerise eshte ne adresen Rruga "Donika Kastrioti", Vila nr. 1/1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Marrja përsipër dhe kryerja e çdo biznesi reklamues, prodhimi i materialeve reklamuese dhe ofrimi i shërbimeve reklamuese në përgjithësi;
 - Marrja përsipër, kryerja dhe ofrimi i shërbimeve të marrëdhënieve për publikun, sponsorizimet, promocioneve të shitjeve dhe shërbime të komunikimit në përgjithësi.
 - Marrja përsipër dhe kryerja e çdo veprimtarie tjetër në përmbushje të objektivave dhe veprimtarive të mësipërme.
 - Kryerje studimesh dhe ofrim këshillash dhe shërbimesh në çështje organizimi, training personeli dhe funksionimi më efektiv të ndërmarrjeve dhe organizatave që janë në funksionim ose parashikohet të krijohen në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe çështje që kanë të bëjnë me plane investuese të këtyre shoqërive.
 - Ofrim shërbimesh këshillimore financiare, investimesh, komunikimi dhe zhvillimi dhe në përgjithësi dhënia e shërbimeve këshilluese të të gjitha llojeve, natyrave dhe përmbajtjeve për persona fizikë dhe juridikë ose/dhe organeve të pushtetit lokal ose/dhe shtetit.
 - Ofrim i shërbimeve të blerjeve dhe "central bying".
 - Ofrim shërbimesh menaxhimi, tatimi, financiare, kompjuterizimi, organizimi dhe mbështetje dhe në përgjithësi shërbime personeli, udhëzim metodash të rritjes së shitjeve dhe administrimi financiar si dhe në përgjithësi ofrimi i shërbimeve të organizimit, drejtimit dhe administrimit të ndërmarrjeve.
 - Ortakëri, dhe/ose drejtim ndërmarrjesh të tjera me anë të blerjes së aksioneve.
- Kohezgjatja e shoqerise eshte 15 (pesembedhjetë) vjet.



Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2 000 000 (dy milion) leke i ndare ne 2 000 aksione me vlere nominale 1 000 (nje mije) leke secili.
Drejtor i pergjithshem i shoqerise eshte z. Adrian Garo.

Bazuar ne sa me siper si dhe ne Ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe Ligjin Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", parashtroj kete kerkese per depozitim ne Regjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise dhe pasqyrimin e ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise.

KERKUESI
Per shoqerine "DDB ALBANIA" SHA

Drejtori i Pergjithshem

Adrian GARO

Adrian Garo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 1301 . REP.
NR. 183 . KOL.

VERTETIM

Sot me date 18 dhjetor 2000 para meje, Doukë Noçi, notere e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht:

- Ardian Garo lindur më 8 korrik 1970, në Vrisera, Gjirokastrë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës QH nr. 335698.

madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i cili ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise "DDB ALBANIA" SHA, Tirane, me paraqiti kete kerkese per regjistrim personi juridik, dhe pasi e nenshkroi ate rregullisht para meje, une noterja e vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

NOTERE



Doukë Noçi



ARTICLES OF MEMORANDA

of

«DDB ALBANIA» SHA

The following shareholders have agreed to establish in Tirana a company named «DDB ALBANIA» SHA in compliance with the present Articles of Memoranda, Articles of Association and Albanian Law "On Commercial Companies":

1. "OLYMPIC DDB (Holding)" S.A., incorporated on 14 January 1988, with registry no. 16436/01AT/B/88/012 with headquartered in 12 Sorou Street, GR - 151 25, Amarousion, Athens, Greece.
2. Mr. Ardian Garo, born on July 8, 1970, in Vrisera, Gjirokaster, resident in Tirana, bearer of passport number QH 335698.
3. Mr. Pandeli Garo, born on October 6, 1964, in Tirana, resident in Tirana, bearer of passport number QH 335699.
4. Mr. Admir Banaj, born on August 23, 1963, in Tirana, resident in Tirana, bearer of passport number AZ 447932.

Article 1 - Legal form

- 1.1 The company is a joint stock one and shall be established under the Albanian Company Laws.

Article 2 - Name

- 2.1 Name of the company is "DDB ALBANIA" SHA.

Article 3 - Registered office. Territory of activity

- 3.1 Registered office of the company will be in the address: Rr. «Donika Kastrioti», Vila nr. 1/1, Tirana-ALBANIA.
- 3.2 The company will carry out its activity within the entire territory of the Republic of Albania. The company may open affiliated offices, subsidiaries, agencies or services throughout Albanian territory by resolution of General Assembly of Shareholders.

Article 4 - Duration

- 4.1 Duration of the company will be fifteen 15 (fifteen) years, commencing from the date of incorporation.
- 4.2 However, the company may be dissolved before the 15 (fifteen)-year term or such



term may be extended by Resolution of General Assembly of Shareholders, according to Albanian legislation.

Article 5 – Object


5.1 Activity of the Company consists of:

- Undertaking and carrying out of any advertising business, the production of advertising material, and the rendering of advertising services in general
- Undertaking, carrying out and rendering of public relations services, sponsorships, sales promotion and communication services in general.
